

## **ARRATISJET NGA KAMPET DHE BURGJET GJATË REGJIMIT TOTALITAR KOMUNIST**

Dr. Femi Sufaj  
Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i Burgjeve  
e-mail: fsufaj@gmail.com

### **Abstrakt**

Historitë e burgjeve janë të mbushura me ngjarje nga më të ndryshmet, veçanërisht arratisjet, të cilat kanë si emërues të përbashkët përpjekjen për liri, pavarësisht çmimit të lartë të saj. Dinamika e arratisjeve ndryshon nga koha në kohë, në varësi të sistemeve politike, ekuilibrave shoqërore, masave të sigurisë, mënyrës së trajtimit të personave të burgosur, por edhe të integritetit të drejtësisë. Përpjekjet për arratisje rriten proporcionalisht me shtypjen, shkeljen e të drejtave, keqtrajtimin dhe padrejtësitë, si tregues tipikë të sistemeve totalitare. Në këtë trajtesë do të përqendrohemi tek fenomeni i arratisjeve nga burgjet dhe kampet gjatë regjimit totalitar komunist, të cilat kishin si qëllim final kalimin përtej kufijve shtetërorë. Të dhënat tregojnë se të gjithë të arratisurit që i shpëtuan ekzekutimit në terren dhe nuk u riarrestuan, u drejtuan drejt kufirit me shpresën për ta kapërcyer atë. Megjithatë, kapërcimi i kufirit ishte një sfidë e paimagjinueshme, për shkak të rrethimit të shumëfishtë dhe masave ekstreme parandaluese, të cilat nuk kursenin as jetën e personit, për shkak se arratisja konsiderohej si krimi më i rëndë kundër shtetit. Largimi nga vendi i vuajtjes së dënimit, si vepër penale, parashikohej me një dënim jo më të gjatë se tre vite burgim në Kodin Penal të RPSSH të periudhës 1952-1977. Kjo tregon se masat ekstreme të ndërmarra nga personeli i burgjeve ndaj të burgosurve që u arratisën ose tentuan të arratiseshin, si ekzekutimet, torturat dhe keqtrajtimet, përveçse përbënin reagime joproporcionale ndaj shkeljes së kryer, përfaqësonin edhe një krim institucional kundër jetës së personit. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të personave të dënuar për largim nga vendi i vuajtjes së dënimit, rezulton se janë dhënë dënime të rënda, deri në 25 vite burgim, madje edhe me vdekje. Këto vendime janë marrë pa prova të argumentuara, duke paragjykuar dhe besuar se të arratisurit nga burgjet kishin qëllim të arratiseshin jashtë shtetit dhe vepra penale e largimit nga vendi i vuajtjes së dënimit, arratisja, është kualifikuar apriori si tradhti ndaj atdheut. Përtej aspekteve formale të këtyre krimeve, përmes dëshmive, por edhe të dokumenteve zyrtare, evidentohen raste shumë më të rënda që kanë të bëjnë me organizimin e arratisjeve nga vetë komandat e burgjeve, në funksion të eliminimeve dhe

terrorit për të mbajtur të burgosurit nën kontroll të plotë. Për trajtimin e këtij studimi është përdorur metoda e analizës së dokumenteve, duke u bazuar si tek burimet parësore nga fondet arkivore, ashtu edhe tek burimet dytësore, të cilat janë paraqitur në mënyrë kronologjike përgjatë periudhës së regjimit komunist. Studimi është hartuar mbi parimet e objektivitetit, verifikueshmërisë dhe respektimit të kontekstit historik në të cilin kanë ndodhur ngjarjet. Analiza fokusohet tek rastet e arratisjeve nga burgjet dhe kampet e shtetit totalitar, me qëllim evidentimin e rrethanave, metodave dhe pasojave të këtyre përpjekjeve. Studimi mbështetet jo vetëm në burime zyrtare, por gjithashtu edhe në kujtime, dëshmi dhe raporte të ish-të dënuarve politik. Në këtë mënyrë, trajtimi i fenomenit synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të përpjekjeve individuale për liri, si dhe të mekanizmave represive që ata sfiduan.

**Fjalë kyçe:** *arratisje, të burgosur politikë, ekzekutime, kufij shtetërorë, kampet e shtetit komunist.*

Qëllimi i studimit është të evidentojë arratisjet nga burgjet dhe kampet gjatë regjimit komunist, si momente kulmore të reagimit ndaj shtypjes dhe dhunës së regjimit totalitar, duke kontribuar kështu në ruajtjen e kujtesës historike dhe edukimin e brezave të rinj në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore.

### **Objektivat e studimit**

- Të analizojë kontekstin e instalimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale në kushtet e një regjimi totalitar.
- Të identifikojë në mënyrë shteruese të gjitha rastet e arratisjeve nga kampet dhe burgjet e shtetit totalitar, me qëllim administrimin dhe bashkërendimin e të gjitha informacioneve në një dokument të vetëm.
- Të analizojë faktorët nxitës dhe tërheqës që çuan ish-të burgosurit drejt arratisjes, profilin e tyre, reagimin e institucioneve të regjimit totalitar, si dhe pasojat fatale për personat e arratisur dhe grupet e tjera të prekura.

Trajtesa përbëhet nga katër çështje kryesore:

- a) Ngritja e institucioneve të drejtësisë penale si instrumente të diktaturës së proletariatit. Në këtë nënçështje prezantohen hapat e parë të ngritjes së sistemit gjyqësor dhe të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat kanë zbatuar politikën e Partisë Komuniste (më vonë Partia e Punës) për sigurinë, drejtësinë dhe luftën e klasave. Struktura tradicionale e drejtësisë u eliminua dhe u zëvendësua me seksione të drejtësisë, gjykata

ushtarake, gjykata popullore dhe Gjykatën e Lartë. U ngritën organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përfshirë Sigurimin e Shtetit dhe policinë, të cilat administrojnë kampet dhe burgjet. Reforma e sistemit penal rezultoi me mbushjen masive të burgjeve dhe kampeve të internimit, një fenomen pa precedent në historinë e Shqipërisë.

- b) Konteksti historik: izolimi dhe kriminalizimi ekstrem i largimit nga vendi. Kjo çështje trajton kriminalizimin e largimit jashtë vendit si tradhti ndaj atdheut, duke u konsideruar si krimin më të rëndë. Masat parandaluese përfshinin internime, dëbime dhe dënime maksimale, duke bërë që arratisjet të përbënin pjesën kryesore të dënimeve për vepra penale kundër shtetit.
- c) Arratisjet si akt guximi dhe rezistence. Ky segment paraqet në mënyrë kronologjike arratisjet nga burgjet, kampet e punës dhe të internimit gjatë regjimit komunist. Për shkak të mungesës së burimeve të plota, nuk pretendohet që të jenë përfshirë të gjitha episodet, por studiuesit mund ta vazhdojnë pasurimin e kësaj teme në të ardhmen.
- d) Arratisjet si akte të montuara për të shtuar kontrollin dhe frikën. Kjo çështje trajton një aspekt të pa kërkuar deri më tani. Në disertacionin e doktoratës së autorit, me temë “Sistemi i ndëshkimeve gjatë regjimit komunist” (2014), paraqitet veprimtaria e komandës së kampit të Bulqizës lidhur me dy arratisje të hetuara nga Hetuesia e Përgjithshme në vitin 1969. Evidentohet se arratisjet janë montuar dhe parapërgatitur nga komandat, për të justifikuar dhunën dhe ekzekutimin e të burgosurve, duke forcuar kontrollin dhe demonstruar gatishmërinë e strukturave për t’i shërbyer pushtetit popullor.


## Hyrje

Periudha 1945-1990 në Shqipëri shënoi vendosjen e një regjimi totalitar, i cili u karakterizua nga kontrolli i rreptë i shtetit mbi jetën politike, shoqërore dhe individuale. Në këtë kontekst, një rol kyç në ruajtjen e rendit dhe në ndëshkimin e çdo forme të kundërshtimit politik luajtën burgjet, kampet e internimit dhe institucionet e sigurisë. Sistemet e izolimit dhe të kontrollit të përqendruar nuk ishin vetëm mekanizma për të mbajtur nën kontroll popullsinë, por edhe mjete për të krijuar një frikë të përhershme, duke e shtrirë efektin e tyre mbi individin, familjen dhe bashkësinë e gjerë. Arratisjet nga këto institucione përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë së burgjeve, pasi tregojnë përpjekjet e individëve për të sfiduar sistemet e izolimit dhe për të kërkuar lirinë, shpesh duke rrezikuar jetën e tyre. Çdo arratisje përfaqësonte një akt rezistence personale dhe kolektive, një përpjekje për të ruajtur dinjitetin dhe mbajtur shpresën në një mjedis ku çdo shenjë e pavarësisë mund të shndërrohej në pasojë fatale. Ndërsa për të burgosurit, në përgjithësi, dëshira për liri mund të duket e natyrshme, në kushtet e shtetit totalitar, këto përpjekje merrnin dimensionin e akteve të guximit, qëndresës dhe vendosmërisë për t’u përballur me mekanizmat represive, deri në vetëmohim. Ky kontekst tregon se arratisjet nuk ishin vetëm një çast rebelimi, por një reflektim i përhershëm i tensionit midis individit dhe pushtetit shtypës, duke

theksuar rëndësinë e studimit të këtij fenomeni, për të kuptuar dinamikën e jetës në institucionet e regjimit dhe reagimin e individëve, për të ruajtur lirinë dhe dinjitetin e tyre.

### **Ngritja e institucioneve të drejtësisë penale si instrumente të diktaturës së proletariatit.**

Programi i bazuar tek ideologjia komuniste, për ndërtimin e një sistemi politik të qëndrueshëm, i drejtuar nga një parti e vetme, parashikonte fillimisht eliminimin fizik të forcave opozitare, të cilat konsideroheshin si pengesë për konsolidimin e shtetit të ri. Ky shtet u prezantua si shteti i punëtorëve dhe fshatarëve, ose si “shteti i popullit”<sup>1</sup>. Gjithë shoqëria u nda në dy grupe, “NE” dhe “ATA”. “NE” ishin shumica, pjesa e popullit nën drejtimin e partisë, që lufton për zhvillim dhe përparim dhe “ATA” përfaqësonin “armiqtë e popullit”. Historia e eliminimeve ka filluar në ditët e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe ka vazhduar deri në rrëzimin e regjimit, në vitet 1990, duke u konsoliduar si rezultat i zhvillimit të luftës së klasave, që në vizionin e saj kishte luftën e pandërprerë deri në zhdukjen përfundimtare të të ashtuquajturave klasa shfrytëzuese. Vrasjet gjatë Luftës N-Ç dhe në ditët e fundit të saj, që dukeshin si veprime taktike për marrjen e pushtetit, u ngritën në nivel strategjie që solli mijëra të ekzekutuar, të dënuar e të internuar, gjë që ishte një pasqyrë e qartë e shtetit të tipit diktaturë. Sistemi i ri i drejtësisë penale, i zhveshur nga gjithë fryma demokratike dhe i pastruar nga të gjitha strukturat e mëparshme do t’i shërbente Partisë Komuniste, më vonë Partia e Punës, për të qeverisur e vetme, duke eliminuar këdo që ajo e vlerësonte pengesë, qoftë edhe të dyshuar, në rrugën e zgjedhur. Administrata e drejtësisë, sipas tabelës së roleve organike, të hartuar më 1 korrik 1944, kishte një strukturë prej 639 punonjësish, ku përfshiheshin gjykatës, ndihmës gjyqtarë, prokurorë, ftues, sekretarë dhe ndihmës sekretarë, të të gjitha shkallëve të gjyqësorit dhe prokurorisë.<sup>2</sup> E gjithë kjo strukturë, në rastin më të mirë, u pushua nga puna dhe shumica e tyre u përndoqën, u dënuan dhe një pjesë e mirë u larguan jashtë vendit, për t’i shpëtuar terrorit, pa hyrë në vitin 1945. Një informacion mbi personelin e gjykatave ushtarake të vendit, e hartuar nga seksioni juridik i Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, më 18 maj 1945, tregon se shumica e pozicioneve kryesore drejtuese ishin mbushur me persona të cilët kishin qenë pjesëmarrës në Luftën Nacional-Çlirimtare, si dhe konstatohet që një pjesë e konsiderueshme e pozicioneve ishin lënë të paplotësuara, për të cilat si alternativë është shënuar që “mund të emërohet ndonjë oficer besnik apo komisar”.<sup>3</sup> Rreth 14 vite më vonë, pra në vitin 1958, shikojmë se gjendja arsimore e prokurorisë ishte e një niveli shumë të ulët.



<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, viti 1946.

<sup>2</sup> F. Ministria e Drejtësisë (515), V.1944, D 4, fl.20, Arkivi Qendror i Shtetit.

<sup>3</sup> F. 516, V.1945, D 15, fl.1, Arkivi Qendror i Shtetit.

Në vitin 1958, në gjithë vendin, nga 144 prokurorë dhe hetues 13 kishin shollë fillore, 65 shkollë unike,<sup>(4)</sup> 21 me arsim të mesëm dhe 45 me arsim të lartë.<sup>5</sup> Më datën 26 dhjetor 1944, me anë të “Qarkores” nr.2, Ministria e Drejtësisë njofton të gjithë këshillat çlirimtare të prefekturave dhe nënprefekturave, për të krijuar seksione të drejtësisë provizore, deri sa të ngrihen gjykatat e rregullta, të cilët, me anë të masave provizore, do të shqyrtojnë çështje që kanë karakter tepër të ngutshëm.<sup>6</sup> Çështjet penale ishin vetëm në kompetencë të gjykatave ushtarake, ndërsa seksionet e drejtësisë, nuk e kishin atributin e vërtetë të një gjykate, pasi, - siç thuhet në qarkore, - masa provizore e marrë nga një seksion drejtësie nuk ia mohon të drejtën palëve që t’i drejtohen më vonë gjyqit të rregullt, për rishqyrtimin e çështjeve.<sup>7</sup> Në çdo seksion do të bënte pjesë një gjyqtar, i cili përveç aftësive profesionale duhet të ishte shquar edhe për mbështetje të lëvizjes antifashiste nacional-çlirimtare. Organet kryesore të gjykimit të krimeve, sidomos ato që konsideroheshin krime kundër luftës, tradhti, bashkëpunim me okupatorët etj., kanë qenë gjykatat ushtarake. Gjykatat ushtarake u krijuan me ligjin nr. 41, datë 14 janar 1945 të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar<sup>8</sup> dhe përbëheshin nga Gjykatat Ushtarake të Korpusit, pranë çdo Korp-Armate dhe Gjykatat Ushtarake të Krahinës. Gjykatat Ushtarake të Krahinës ushtarake të korpusit gjykonin persona të etiketuar si kriminelë të luftës, aktet e armiqve të popullit, ushtarakët e prapavijave dhe robërit e luftës, ushtarakët e njësisë të tyre, civilët që kishin kryer vepra penale dhe krime para ose pas çlirimit, nëse këto krime lidheshin me interesat e lëvizjes antifashiste nacional-çlirimtare.<sup>9</sup> Ligji parashikonte edhe rolin e prokurorit pranë gjykatës ushtarake, në hetimin dhe vlerësimin e masës së sigurisë arrest me burg, në marrëveshje me kryetarin e gjykatës. Zbatimi i ligjit për krijimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake hasi në vështirësi të mëdha, që vinin së pari nga mungesa e gjykatësve të kualifikuar dhe nga angazhimi në detyrën e gjykatësve dhe të prokurorëve e të ushtarakëve të cilët ishin ngarkuar me detyra të tjera të përhershme. Problematika të mëdha u krijuan edhe lidhur me juridiksionin dhe kompetencën gjyqësore, për shkak të funksionimit të shumë gjykatave.

Pas daljes së ligjit nr.61, datë 17 maj 1945, për abrogimin e dispozitave ligjore gjatë okupacionit dhe pavlefshmërinë e vendimeve penale të dhëna gjatë asaj periudhe, ishte krijuar një çoroditje në organet e drejtësisë, të cilët në shumë raste nuk dinin se cilit ligj do t’i referoheshin në kualifikimin e një veprë penale dhe në dhënien e dënimit. Sipas një raporti të Seksionit Juridik të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, të datës 5 korrik 1945, “sistemi i ndjekur deri tani ka shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjeve të kriminelëve të luftës, armiqve

---

<sup>4</sup> “Shkolla të veçanta 3-vjeçare mbi filloren, të quajtura unike, u hapën që në vitin shkollor 1945-1946. Më tej, ato iu bashkuan shkollës fillore, duke krijuar ciklin e plotë të 7-vjeçares”. Shih Enriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri (1945-1960)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, 2005), f. 117. (Shënim i redaktorit)

<sup>5</sup> F. Prokuroria e Përgjithshme, D.28, V.1958, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

<sup>6</sup> F. Ministria e Drejtësisë (515), V.1944, D 2, fl.2, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> F. 516, V.1945, D 9, fl.2, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

<sup>9</sup> F. 516, V.1945, D 17, fl.2, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

të popullit, ushtarakëve dhe civilëve. Nëpër burgje janë grumbulluar të burgosur më shumë se kapaciteti mbajtës i tyre dhe janë krijuar vështirësi për ushqimin dhe mbajtjen e tyre”.<sup>10</sup>

~~1/ Te burgosurit ordinar mvarren nga Prokurorat e Gjykatave te Prefekturave dhe administrimi i burgut, ruajtja, ushqimi mvarret nga Ministrija e Fete Mbrendeshme;~~  
~~2/ Kriminellet e luftes e armiqte e popullit duhet te grumbullohen ne nje burg te vecante mbasi mvarren prej Gjykatave ushtarake dhe prej Drejtorie se Mbrojtjes.~~  
~~3/ Te burgosurit ushtarake ne Qendrat e Prefekturave perveg Tiranës jane perqendrohet bashke me te burgosurit e tjere.~~

Në rastet e krimeve politike, prokurori duhej të informonte Organet e Mbrojtjes së Popullit (më vonë u quajtën Organet e Sigurimit) dhe do t'i bënin hetimet së bashku. Për të krijuar një ide më të qartë të dënimeve që janë dhënë në vitin 1945 nga Gjykata Ushtarake e Korpunit Tiranë dhe nga Këshilli Gjyqësor i Qarkut Durrës, na ndihmon tabela në vijim.<sup>11</sup>

| Lloji i dënimeve dhe numri i të dënuarve | Keshilli Gjyqësor i Qarkut Tiranë Janar-Qershor |              | Keshilli Gjyqësor i Qarkut Durrës Janar-Qershor |              | Gjykata Ushtarake Tiranë |              |                      |              |
|------------------------------------------|-------------------------------------------------|--------------|-------------------------------------------------|--------------|--------------------------|--------------|----------------------|--------------|
|                                          |                                                 |              |                                                 |              | Janar-Qershor 1945       |              | Qershor-Dhjetor 1945 |              |
| Numri i vendimeve të dhëna               | 49                                              |              | 55                                              |              | 178                      |              | 828                  |              |
| Koha e kryerjes së veprës                | Para Çlirimit                                   | Pas Çlirimit | Para Çlirimit                                   | Pas Çlirimit | Para Çlirimit            | Pas Çlirimit | Para Çlirimit        | Pas Çlirimit |
| Vdekje, varje ose pushkatim              | -                                               | -            | 7                                               | -            | 38                       | 10           | 4                    | 12           |
| Burgime të përjetshme                    | -                                               | 2            | 8                                               | -            | 11                       | -            | 1                    | 6            |
| Burgim me 101 vjet                       | -                                               | -            | -                                               | -            | -                        | -            | -                    | -            |
| Burgim 20-30 vjet burg                   | 1                                               | -            | 9                                               | -            | 11                       | -            | 3                    | 27           |
| Burgim 15-20 vjet burg                   | -                                               | -            | 2                                               | -            | 14                       | -            | 1                    | 29           |
| Burgim 10-15 vjet burg                   | -                                               | -            | 10                                              | -            | 18                       | -            | 2                    | 70           |
| Burgim 5-10 vjet                         | -                                               | -            | 11                                              | 9            | 34                       | 27           | 1                    | 408          |

<sup>10</sup> F. 516, V.1945, D 17, fl.2, Arkivi Qendror i Shtetit.

<sup>11</sup> F. 516, V.1947, D 20, fl.9, Arkivi Qendror i Shtetit.

|                                           |   |    |   |   |    |   |    |     |
|-------------------------------------------|---|----|---|---|----|---|----|-----|
| Dënime deri në 5 vjet                     | - | 44 | - | - | -  | - | -  | -   |
| Dënime me kondicion                       | - | -  | - | - | 8  | - | -  | 94  |
| Dënim me gjobë                            | - | 4  | - | - | -  | - | 7  | 102 |
| Humbje të të drejtave civile dhe politike | - | 1  | - | - |    |   | 10 | 51  |
| Pafajësi                                  | - | 17 | 9 | 1 | 26 | 5 | -  | 32  |

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar me dekretin nr.59, datë 17 maj 1945, miratoi ligjin për organizimin e përkohshëm gjyqësor.<sup>12</sup> Institucionet që ngarkohen nga ligji për dhënien e drejtësisë ishin Gjykatat popullore, Gjykatat e Prefekturës dhe Gjykata e Lartë. Juridiksioni për faje ushtarake rregullohej me ligj të veçantë. Pranë gjykatës së prefekturës ndodhej një përfaqësues i ligjit, me titull prokuror i shtetit dhe pranë gjykatës së lartë një prokuror i përgjithshëm. Gjyqtarët e emëruar do të gradoheshin dhe transferoheshin me dekret të Kryesisë së Këshillit Nacional-Çlirimtar mbi propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Gjyqtarët popullorë do të zgjidheshin në bazë të ligjit së posaçëm. Në çdo qendër prefekturë dhe në nënprefektura do të krijoheshin gjykatat popullore. Gjykatat popullore kishin në përbërje nga një gjykatës të emëruar dhe dy gjyqtarë popullorë në rolin e ndihmës. Gjykatat popullore shqyrtonin çështjet civile deri në një kufi të caktuar dhe çështjet penale, kundërvajtjet dhe vepra të cilat ndëshkoheshin me një dënim jo më shumë se 5 vjet, me gjobë ose me ndëshkime të tjera, përveç privimit të lirisë (neni 30). Gjykata e prefekturës gjykonte çështjet civile nga tre gjyqtarë, një të emëruar dhe dy gjyqtarë popullorë, ndërsa në çështjet penale gjykonte me dy gjyqtarë të emëruar dhe tre gjyqtarë popullorë, duke u quajtur në këtë rast gjykata kriminale. Në kryeqytet krijohesh një gjykatë e lartë, juridiksioni i së cilës shtrihet mbi gjithë Shqipërinë. Gjykata e Lartë do kishte një numër prej 8-10 anëtarësh dhe dy kryetarë. Ligji parashikonte edhe funksionimin e prokurorisë. “Prokurori i shtetit ishte përfaqësues pranë autoritetit gjyqësor të ligjit të vënë prej popullit. Prokurorët e shtetit do të vareshin nga Prokurori i Përgjithshëm i Gjykatës së Lartë dhe të gjithë janë nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë”<sup>13</sup>. Funksionarët e emëruar të gjykatave shkallëzoheshin në bazë të gradave. Kryetarët e Gjykatës së Lartë dhe prokurori i Përgjithshëm mbanin gradën e parë. Gradat renditeshin deri në të shtatën, ku këta të fundit ishin ndihmës gjyqtarët. Hierarkia e sistemit gjyqësor ishte e trashëguar nga periudha e monarkisë.

Me ligjin nr. 60, datë 17 maj 1945, u përcaktua mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve popullorë.<sup>14</sup> Si të tillë zgjidheshin të gjithë personat që ishin anëtarë të Këshillit Nacional-Çlirimtar dhe që dinin

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare nr.12, datë 22 maj 1945


<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

të shkruanin dhe të lexonin. Ata zgjidheshin për një kohë të pacaktuar. Me këtë ligj krijoheshin dy prej institucioneve më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale: sistemi gjyqësor dhe prokuroria e shtetit. “Në përgjithësi, organizimi i gjykatave civile ka ndjekur atë të sistemit gjyqësor që ka ekzistuar para periudhës së pushtimit italian”.<sup>15</sup> Por, ky sistem nuk do të kishte jetë të gjatë, për shkak se sistemi i ri politik kërkonte të kishte një kontroll absolut mbi drejtësinë. Miratimi i Kushtetutës në vitin 1946 solli nevojën e ndryshimit të ligjeve të miratuara më parë nga shteti komunist, për t’i sjellë ato në frymën e kushtetutës. Kuvendi Popullor, më 13.8.1946, miratoi organizimin dhe kompetencën e gjykatave ushtarake dhe të prokurorisë ushtarake të ushtrisë kombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Gjykatat ushtarake u ngritën në përshtatje me njësitë përbërëse të forcave të armatosura qendrore dhe rajonale. Sipas këtij ligji organet e drejtësisë në ushtrinë kombëtare do të ishin:

- Gjykata e Lartë Ushtarake,
- Gjykata Ushtarake e Divizioneve,
- Gjykata Ushtarake e Mbrojtjes së Popullit,
- Gjykata Ushtarake e Marinës,
- Gjykata Ushtarake e Garnizonit të Tiranës,
- Gjykata Ushtarake e Zonës Ushtarake të Shkodrës.<sup>16</sup>



<sup>15</sup> Bernd Fischer, *Shqipëria 1943-1945. Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore* (Tiranë: AIIS, 2012), f. 72.

<sup>16</sup> F. 516, V.1946, D 20, fl.9, Arkivi Qendror i Shtetit.



Detyra e këtyre gjykatave ishte mbrojtja e rendit të vendosur në ushtri dhe në Sigurimin e shtetit. Oficerët gjykoreshin në shkallë të parë dhe të fundit vetëm nga Gjykata e Lartë Ushtarake, e cila gjykonte në shkallë të dytë mbi bazën e ankimimit kundra vendimeve të të gjitha gjykatave ushtarake të ulta. Vendimet me vdekje të dhëna nga gjykatat ushtarake të ulëta nuk mund të ekzekutoheshin pa miratimin e Gjykatës së Lartë Ushtarake. Personeli i gjykatave ushtarake përbëhej nga oficerë të ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Në kompetencë të gjykatave ushtarake ishin fajet penale të personave ushtarakë, si dhe fajet penale të personave civilë, kur këto synojnë në dobësimin e mbrojtjes kombëtare dhe në nxjerrjen e sekreteve, apo kur janë kryer në zonat e operacioneve ushtarake. Prokuroria ushtarake parashikohej në ligj si organ i Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura, që ka për qëllim të mbrojtë rendin juridik dhe të bëjë ndjekje penale kundra veprave penale në Ushtrinë Kombëtare.<sup>17</sup> Prokuroria ushtarake ishte ngritur sipas ndërtimit të gjykatave ushtarake. Emërimi dhe lirimi i prokurorit ushtarak dhe të prokurorëve të tjerë bëhej me urdhër të Komandantit të Forcave të Armatosura.

| Rrethi    | Nr. pergj. | Nga keta |      |      | Nr. pergj. i t'arest. te pushuar | Nga keta |      |         |
|-----------|------------|----------|------|------|----------------------------------|----------|------|---------|
|           | i t'arest. | Prek.    | Sig. | Pel. |                                  | Prek.    | Sig. | Pellic. |
| Tirane    | 273        | 88       | 26   | 159  | 9                                | 6        | -    | 3       |
| Vlone     | 62         | 40       | 5    | 17   | 3                                | 3        | -    | -       |
| Kukesi    | 39         | 24       | 9    | 6    | 3                                | 1        | 2    | -       |
| Kruja     | 75         | 38       | 2    | 35   | 5                                | 2        | -    | 3       |
| Peshkepi  | 35         | 26       | 9    | 10   | 3                                | 2        | 1    | -       |
| Durres    | 153        | 73       | 21   | 59   | 5                                | 3        | 1    | 1       |
| Elbasan   | 89         | 31       | 20   | 38   | 3                                | -        | 3    | -       |
| Gjirekas. | 24         | 13       | 5    | 6    | 3                                | -        | -    | 3       |
| Fier      | 76         | 31       | 16   | 9    | 1                                | 1        | -    | -       |

<sup>17</sup> F.516, V.1946, D 20, fl.11, Arkivi Qendror i Shtetit.

|          |      |     |     |     |    |    |    |    |
|----------|------|-----|-----|-----|----|----|----|----|
| Shkoder  | 140  | 52  | 44  | 44  | 3  | 3  | -  | -  |
| Pogradec | 33   | 11  | 12  | 15  | -  | -  | -  | -  |
| Lushnja  | 43   | 13  | 7   | 23  | 1  | 1  | -  | -  |
| Saranda  | 37   | 19  | 11  | 7   | -  | 1  | 1  | -  |
| Gjramshi | 6    | 4   | 1   | 1   | 1  | 1  | -  | -  |
| Skrapar  | 11   | 2   | -   | 9   | -  | -  | -  | -  |
| Fuke     | 22   | 11  | -   | 11  | 1  | 1  | -  | -  |
| Tepelene | 20   | 8   | 4   | 8   | -  | -  | -  | -  |
| Trepeja  | 23   | 11  | 8   | 4   | -  | -  | -  | -  |
| Burreli  | 23   | 18  | 1   | 4   | 1  | 1  | -  | -  |
| Reshemi  | 18   | 10  | 5   | 3   | 1  | 1  | -  | -  |
| Lezha    | 14   | 14  | -   | 4   | -  | -  | -  | -  |
| Librazhd | 16   | 11  | -   | 5   | 1  | 1  | -  | -  |
| Kelenja  | 13   | 9   | 2   | 2   | -  | -  | -  | -  |
| Kerça    | 86   | 33  | 21  | 32  | 9  | 2  | 7  | -  |
| Berati   | 49   | 21  | 7   | 21  | -  | -  | -  | -  |
| Permeti  | 14   | 7   | 3   | 4   | 1  | -  | 1  | -  |
| Totali   | 1420 | 618 | 240 | 562 | 56 | 30 | 16 | 10 |

18

Organizimi i drejtësisë u është nënshtruar ndryshimeve të vazhdueshme, të cilat në thelb kishin forcimin e shtetit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave kundër kundërshtarëve të regjimit. Në qershor 1951, Kuvendi Popullor e ndryshoi përsëri ligjin mbi organizimin gjyqësor. Në dispozitat e përgjithshme të ligjit theksohej që, si kundër sanksionohet në nenin 79 të Kushtetutës, drejtësia në Republikën Popullore të Shqipërisë jepet nga Gjykata e Lartë, gjykatat popullore dhe gjykatat ushtarake. Në ndryshim nga ligjet e mëparshme, ky ligj e thekson më shumë frymën klasore dhe politike, gjë që shprehet drejtpërdrejt në nenin 2 mbi misionin e drejtësisë, ku thuhet se ka për detyrë të mbrojë nga çdo cenim organizimin shoqëror dhe shtetëror në Republikën Popullore të Shqipërisë, të vendosur me kushtetutë, sistemin socialist të ekonomisë dhe pasurinë socialiste.<sup>19</sup> Gjykata, me anë të veprimtarisë së saj, edukon shtetasit me frymën e dashurisë për atdheun dhe për socializmit, i mëson të zbatojnë ligjet dhe të ruajnë pasurinë

<sup>18</sup> F.492, V.1964, D 58, Përgjithësim mbi arrestimet 1961-1964.

<sup>19</sup> Fletorja Zyrtare nr.20, korrik 1951.

socialiste.<sup>20</sup> Ky ligj solli disa ndryshime në organizimin dhe mënyrën e zgjedhjes dhe të emërimit të gjykatësve. Kështu, kryetarin e gjykatës ushtarake dhe gjykatësit nuk e zgjidhte më Komandanti Supreme i Forcave të Armatosura, por ata zgjidheshin nga Kuvendi Popullor- me një mandat 4-vjeçar.

### **Ngritja e strukturave në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.**

Në strukturën e sistemit të drejtësisë penale instrumentet më të fuqishëm, më autoritarë, më të frikshëm dhe më shtypës, kanë qenë strukturuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Autoriteti i kësaj ministrie arriti pikat më të larta gjatë drejtimit të saj nga Koçi Xoxe, ku kishte arritur një kontroll absolut mbi të gjitha institucionet e tjera shtetërore dhe mbi vetë Partinë që e kishte krijuar. Institucionet kryesore përbërëse të sistemit të drejtësisë penale, përveç gjykatave dhe prokurorisë, të cilat konsideroheshin të pavarura, të strukturuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë qenë Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Policia Popullore, burgjet, kampet dhe hetuesia e cila pas vitit 1983 krijohet si institucion i pavarur. Misioni kryesor i institucioneve të drejtësisë penale ishte mbrojtja e shtetit dhe zyrtarisht kanë qenë njohur si organe të diktaturës së proletariatit, pra organe që kanë funksion dhune dhe shtypje. Ky funksion përcaktonte politikën kriminale dhe luftën juridiko-penale, si formë kryesore të luftës kundër kriminalitetit, të bazuar në dënimin penal dhe masat e tjera shtrënguese.<sup>21</sup>

Që në ditët e para të hyrjes në Tiranë, Qeveria e Përkohshme Demokratike krijoi Divizionin e Mbrojtjes së Popullit dhe Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit, në të cilat ishin përfshirë pjesa më besnike e luftëtarëve të Lëvizjes Nacional Çlirimtare. “...një nga divizionet që dikur ishte pjesë e ushtrisë, është organizuar dhe stërvitur si forcë e policisë. Për kryerjen e detyrave të tij, Divizionit të Popullit i vjen në ndihmë edhe ushtria”.<sup>22</sup> Ky mekanizëm ka shërbyer për asgjësimin me dhunë, ekzekutimin dhe burgosjen e të gjithë kundërshtarëve të regjimit komunist, si dhe për nënshtrimin e krahinave të tëra të vendit, për t’i hapur rrugën shtrirjes së pushtetit komunist. Divizioni i Mbrojtjes së Popullit ishte një strukturë operacionale-ushtarake dhe operative në varësi të Komandës së Përgjithshme të Forcave Ushtarake, që ka funksionuar, nga dhjetori i vitit 1944, deri në vitin 1949. Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte shërbim sekret. Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit është krijuar më 10 dhjetor 1944 dhe drejtohej nga Koçi Xoxe. Struktura organizative e Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit është ndryshuar gjatë viteve 1944-1946. Deri në fundin e vitit 1945, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 1946 u quajt Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe kaloi nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit ishte paraardhës i Sigurimit të Shtetit dhe organi kryesor me anë të të cilit udhëheqja komuniste mbajti pushtetin të pandarë me asnjë parti tjetër dhe arriti të eliminonte në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose pas shpine, të gjithë individët apo grupet që i mendonte të ishin kundërshtarë të saj. Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, mbulonte disa fusha të

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Ismet Elezi dhe Vasilika Hysi, *Politika Kriminale* (Tiranë: PEGI, 2006), f. 64.

<sup>22</sup> Fischer, *Shqipëria 1943-1945. Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*, fq.63.

posaçme, siç ishin kontrolli politik i anëtarëve të partisë, zbulimin dhe spiunazhin, propagandën dhe censurën, ruajtjen e personaliteteve, si dhe kampet e burgjet dhe njëhej ndryshe si Drejtoria e Dhjetë. Sigurimi i Shtetit kishte për objekt zbulimin dhe hetimin e krimeve kundër shtetit dhe bashkëpunonte ose jo me organe të tjera të procedimit penal, si prokuroria apo policia. Shumicën e çështjeve që hapte Sigurimi i Shtetit i dërgonte vetë në gjyq.

Në maj të vitit 1945 u bë riorganizimi i strukturave ushtarake dhe u krijua Policia Popullore. Funksionet e policisë u përcaktuan në nenin 4 të Ligjit nr. 114, datë 30 gusht 1945, ku thuhej: “Policia garanton sigurimin personal të qytetarëve, ruan pasurinë private e shtetërore, ... mban rregullin dhe qetësinë publike, rregullon qarkullimin, mbron higjienën publike, bën shërbime në burgje dhe ndalon çdo lloji krimi”.<sup>23</sup> Pas miratimit të Kushtetutës, u rimor në shqyrtim edhe ligji mbi organizimin e policisë dhe më 9 shtator 1946, me ligjin nr.371 u ndryshua mënyra e organizimit dhe e funksionimit të policisë. U krijua Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me disa degë si organizimi, krimet, rendi publik, administrata, financa, burgjet, policia rrugore, mbrojtja nga zjarri, pasaportat dhe seksioni i shkollave. Policia u organizua në nivel prefekturë dhe nënprefekturë, me seksione dhe nënseksione. Në shtator të vitit 1947, policia kishte një efektiv prej 4.518 punonjës, nga të cilët 3.923 policë, 488 nënoficerë dhe 126 oficerë.<sup>24</sup> Në dhjetor 1944, me urdhër të Qeverisë së Përkohshme Demokratike u hap në Tiranë Burgu nr.5, në të cilin u izoluan personat e etiketuar si armiq të popullit. Burgjet dhe kampet, nga dhjetori 1944, deri në maj 1945, siguroheshin nga Divizioni i Mbrojtjes së Popullit dhe pas kësaj kohe personat që do të procedoheshin për vepra ordinere do të vireshin nën administrimin, drejtimin dhe sigurimin e Policisë Popullore, ndërsa ata të cilët do të procedoheshin për vepra politike kanë qenë nën juridiksionin e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, pra të Sigurimit dhe të gjykatave ushtarake. Gjatë gjithë regjimit komunist burgjet kanë qenë të strukturuar brenda drejtorisë së policisë, në nivel qendror dhe vendor dhe zyrtarisht janë konsideruar si institucione ushtarake, emërtimet e të cilave kanë ndryshuar gjatë viteve, ndonëse në thelb nuk ka ndryshuar përmbajtja, dhe emërtimet e ndryshme si kampe pune, reparte pune, reparte riedukimi, deri në institucione riedukimi, vetëm sa kanë maskuar misionin e vërtetë të tyre, pasi gjatë gjithë periudhës komuniste kanë qenë institucione ndëshkuese.

Qeveria komuniste, e cila erdhi në pushtet në fundin e vitit 1944, u gjend para disa detyrave të vështira, ku me të rëndësishmet ishin ato ekonomike. Për rindërtimin e vendit, në kushtet e nivelit primitiv të forcave prodhuese, u gjet si zgjidhje puna e detyruar e shtetasve pa dallim moshe dhe gjinie. Këtë metodë shteti komunist e aplikoi gjatë gjithë ekzistencës së tij. Punët më të vështira u përballuan nga të burgosurit. Kampet e punës ishin njëkohësisht edhe një zgjidhje për pamundësinë për të strehuar dhe mbajtur e mirë të burgosurit. Si rezultat i politikës së goditjes masive, numri i të dënuarve u rrit me shpejtësi dhe në përmasa të papara. Kështu, më 1 janar 1950 Shqipëria kishte 7.168 të dënuar me heqje lirie dhe 2.000 të internuar, një numër që arrinte gjithsej

---

<sup>23</sup> Hasan Shkëmbi, *Historia e Policisë*, (Tiranë: Shtëpia Botuese Gurra, 1996), fq.106

<sup>24</sup> Po aty, f.109.

në 9.168 persona,<sup>25</sup> pra, me një mesatare prej 753 të dënuar për 100 mijë banorë (popullsia e Shqipërisë më 3.9.1950 llogaritej të ishte në 1.218.900 banorë). Një numër i tillë të dënuarish nuk mund të sistemohej në burgje, të cilat jo vetëm që ishin të shkatërruara, por, edhe po të ishin në gjendjen më të mirë të tyre, kapaciteti i tyre ishte përlllogaritur për një kapacitet 3 herë më të vogël. Në vazhdim të planeve për punësimin e të dënuarve, më 6 dhjetor 1946 Ministri i Punëve të Brendshme Koçi Xoxe i dërgon një shkresë Ministrisë së Punëve Botore dhe Ministrisë së Bujqësisë e Pyjeve, ku midis të tjerave theksonte: “Ndër burgje kemi një numër të konsiderueshëm të burgosur të cilët ushqehen dhe e shkojnë bukën kot. Në mënyrë që të aktivizohen në punë dhe veçanërisht të ekzekutohet dënimi i dhënë me punë të detyruar, ky dikaster ka ngritur si problem futjen e të dënuarve në punë...”<sup>26</sup>

Nga viti 1945, gjer në vitin 1955, në të gjithë Republikën janë dënuar gjithsejt 97.278 persona për krime të ndryshme.

Sipas llojit të dënimeve, këta janë dënuar në këtë mënyrë:

1.545 ..... me vdekje  
 55.976 .....me burgime të ndryshme  
 18.029 .....me gjobë  
 20.343 .....me punë korrektuese  
 1.375 ..... me dënime të tjera.<sup>27</sup>

Statistikë mbi kapacitetin e burgjeve më 1 janar 1951<sup>28</sup>

| Nr. | Burgjet  | Kapaciteti |     | Gjendja në fakt | Mbi kapacitet |
|-----|----------|------------|-----|-----------------|---------------|
| 1   | Tirana   | Politikë   | 287 | 902             | 615           |
|     |          | Ordinerë   | 191 | 873             | 722           |
| 2   | Elbasani | Politikë   | 163 | 216             | 53            |
|     |          | Ordinerë   | 118 | 324             | 206           |
| 3   | Korça    | Politikë   | 221 | 353             | 132           |
|     |          | Ordinerë   | 91  | 487             | 396           |
| 4   | Vlora    | Politikë   | 211 | 130             | 81            |
|     |          | Ordinerë   | 102 | 544             | 442           |

<sup>25</sup> Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D.50, V.1950, *Arkivi i Ministrisë së Brendshme*.

<sup>26</sup> Po aty (Letër e Ministrit të Punëve të Brendshme, Koci Xoxe, dërguar Ministrisë së Punëve Botore, datë 6.12.1946).

<sup>27</sup> F. 14, V. 1957, D 15, fl.1-6, *Arkivi Qendror i Shtetit*, K. Q. i PPSH.

<sup>28</sup> Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1950, D.50, *Arkivi i Ministrisë së Brendshme*.

|   |             |          |       |       |       |
|---|-------------|----------|-------|-------|-------|
| 5 | Shkodra     | Politikë | 256   | 565   | 309   |
|   |             | Ordinerë | 265   | 564   | 309   |
| 6 | Durrësi     | Politikë | 149   | 97    | -52   |
|   |             | Ordinerë | 176   | 308   | 132   |
| 7 | Berati      | Ordinerë | 216   | 487   | 273   |
| 8 | Gjirokastra |          | 351   | 735   | 384   |
| 9 | Burreli     | Politikë | 228   | 581   | 353   |
|   | Shuma       |          | 3.005 | 7.168 | 4.163 |

Periudha pas vitit 1944, deri më deri në rënien e regjimit komunist, është karakterizuar nga metoda të ashpra e represive të organeve të drejtësisë penale, kundër popullsisë, për të realizuar objektivat e komunistëve për vendosjen, ruajtjen dhe konsolidimin e pushtetit. Përdorimi i dhunës, torturave, konfiskimet, madje edhe ekzekutimet dhe terrori ishin metoda të përdorura gjerësisht, veçanërisht nga organet e sigurimit. Në raportin e degës së kampeve dhe të burgjeve, që analizon punën e vitit 1950, përveç “arritjeve” nënvizohet se ndaj të dënuarve janë ushtruar tortura ku të dënuarit janë lidhur me tela në duar e këmbë dhe janë varur me kokë poshtë. Janë lidhur pas shtyllave, në shi dhe në diell. Janë ngarkuar me pesha të rënda, madje kanë mbajtur dhe policët në kurriz, gjatë rrugës për në frontin e punës, për të kaluar kanale ose përrenj. Të dënuarve u është ndaluar ushqimi dhe uji dhe janë rrahur me dru, i kanë detyruar të kalojnë normën me forcë dhe janë izoluar me kohë të gjatë në biruca, duke qenë të lidhur me zinxhir të rëndë.<sup>29</sup> Torturat dhe ndëshkimet arbitrare e më çnjerëzore janë përdorur gjerësisht në ambientet e paraburgimit, kundër të ndaluarve dhe të arrestuarve nga organet e sigurimit të shtetit dhe hetuesia. Qëllimi i përdorimit të torturave dhe i dhunës psikologjike e fizike, të përdorur në ambientet e paraburgimit, ishte së pari për t’i detyruar të arrestuarit që t’i pranonin akuzat ashtu siç i kishin fabrikuar vetë hetuesit.

Pozita e të arrestuarve bëhej më e vështirë për mungesë të mbrojtjes ligjore. Ligjet e aprovuara me dekretet e vitit 1946, 1950, 1953, përcaktonin statusin e avokatit dhe ushtrimin e profesionit të tij. Avokatët grupoheshin në kolegje, të cilat mbikëqyreshin nga Ministria e Drejtësisë. Në gjyqet politike mundësitë për të mbrojtur klientët ishin skajshëm të kufizuara. Avokatëve, me ligj, u kërkohesh që të informonin lidhur me klientët e tyre, madje edhe mund të thirreshin për të dëshmuar kundër tyre. Në nenin 16 të dekretit nr. 1.601, të vitit 1953 “Mbi avokatinë”, theksohet: “Avokati është i detyruar të ruajë sekretin profesional. Avokati detyrohet që të informojë autoritetet shtetërore në se vihet në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit të tij, lidhur me veprimtari

<sup>29</sup> Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D.50, V.1950, *Arkivi i Ministrisë së Brendshme*. Femi Sufaj, *Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shek. XX* (Tiranë: Albin, 2000).

e cila përbën krim kundër shtetit, sipas neneve 64 deri 75 dhe 83 të Kodit Penal”.<sup>30</sup> Avokatët e ushtronin profesionin e tyre nën presion jo vetëm nga pengesat artificiale që nxirreshin prej administratës së burgjeve, hetuesit dhe punonjësit e degëve të punëve të brendshme e të Sigurimit, por edhe nga kufizimet ligjore. Në raportin e Këshillit të Ministrave, më 27.08.1956, mbi kriminalitetin dhe veprimtarinë e gjyqësorit, thuhet se në gjithë republikën ishin afërsisht 140 avokatë “shumica dërmonjëse e tyre janë elementë me kulturë të shkollave borgjeze dhe me mjaft mbeturina nga e kaluara”.<sup>31</sup> Siç dihet, edhe kjo pengesë e vogël, që ishte në mbrojtje të të drejtave të njeriut, u hoq në vitin 1966 me suprimimin e shërbimit të avokatisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Bazuar në një raport mbi kriminalitetin në Shqipëri gjatë viteve 1945-1957,<sup>32</sup> të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton të ishin kryer 109.111 procedime penale vetëm për krime ordinere. Këto shifra nuk përfshijnë krimet kundër shtetit, për të cilat mungojnë të dhënat zyrtare gjatë viteve 1944-1948, ndërsa gjatë viteve 1948-1957 ishin kryer 4.198 procedime penale për krime kundër shtetit. Në një farë mase kjo situatë represive pranohet edhe nga organet kryesore të drejtësisë, të cilën mundohen ta justifikojnë me disa faktorë konkret si mungesa e bazës ligjore të sistemit të drejtësisë penale. “Politika dhe kriteret e procedimit penal kanë qenë të dobëta dhe të pa përcaktuara mirë edhe për mungesë të Kodit të Procedurës Penale”.<sup>33</sup> Kodi Penal dhe i Procedurës Penale nuk kanë qenë miratuar deri në vitin 1952. Sistemi i arrestimeve dhe i dënimeve të periudhës komuniste kishte ngjashmëri me periudhën e fashizmit, jo vetëm nga ashpërsia dhe arbitrariteti, por edhe nga fakti që, përveç prokurorive edhe hetuesisë, kompetenca për të bërë arrestime, hetime dhe për të dërguar çështjen në gjykatë u ishin dhënë edhe disa institucioneve si Sigurimi dhe policia. Gjykatat, nga ana tjetër, nuk kanë ndryshuar asgjë nga klasifikimi i veprave penale dhe nga përfundimet e organeve të hetimit. Parimet e të drejtës penale, si prezumimi i pafajësisë, apo mosdënimi pa ligj dhe me sanksione më të larta sesa janë parashikuar në ligje, nuk janë zbatuar asnjëherë në sistemin e dënimeve, gjatë regjimit komunist dhe as është referuar dhe dhënë informacion për to.

### **Konteksti historik i izolimit dhe kriminalizimi ekstrem i largimit nga vendi.**

Partia Komuniste dhe organet e pushtetit që ngriti ajo vendosën izolimin dhe mbylljen totale të vendit, duke e konsideruar largimin jashtë territorit shtetëror të shtetasve të saj si krim shtetëror dhe tradhti ndaj atdheut. Qëllimi i kësaj mase ishte kontrolli absolut i shtetasve, territorit, ideve, fesë, pronës, të ardhurave, ekonomisë, si dhe ruajtja dhe sigurimi i pushtetit, si forcë e vetme drejtuese. Referuar Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me Dekret Nr.1516, datë 7 gusht 1952, neni 64 “Tradhtia ndaj Atdheut” përmban 9 figura të veprave penale, nga të cilat dy prej tyre janë arratisja jashtë shtetit dhe refuzimi i personit zyrtar shqiptar që ndodhet jashtë shtetit për t’u kthyer në Shqipëri. Kjo dispozitë u mbajt pa u ndryshuar edhe në Kodin Penal të vitit 1977, të miratuar 25 vite më pas. Sanksionet për veprën penale tradhti ndaj

<sup>30</sup> F. Prokuroria e Përgjithshme (492), D 37, V.1960 *Arkivi Qendror i Shtetit*

<sup>31</sup> F. Këshilli i Ministrave (890), V.1956, D 64, fl.28 *Arkivi Qendror i Shtetit*

<sup>32</sup> F. Prokuroria e Përgjithshme (492), V.1960, D 37, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

<sup>33</sup> Po aty.

Atdheut ishte dënim me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet, ose me vdekje. Gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist, dënimet për arratisje ose tentativë arratisje nga atdheu kanë zënë vendin kryesorë në numrin e përgjithshëm të dënimeve për krime kundër shtetit, pas dënimeve për agjitacion e propagandë.

Sipas llojit të krimit zënë këtë përqindje:

|                             |      |         |
|-----------------------------|------|---------|
| - Agjitacion e propagandë   | 43,6 | përqind |
| - Sabotim                   | 5,3  | "       |
| - Terror                    | 2,3  | "       |
| - Diversion                 | 0,5  | "       |
| - Arratisje                 | 3,4  | "       |
| - Tentativë arratisje       | 33,4 | "       |
| - Pjesmarrje në org.K/rrev. | 5,3  | "       |
| - Spiunazh                  | 5,3  | "       |
| - Krimet e tjera së bashku  | 0,9  | "       |

Sipas rretheve dhe llojit të krimit paraqiten: shif pasqyren Nr.1

34

Arratisja ishte kriminalizuar në të gjitha vendet e Lindjes komuniste, por shkalla e ashpërsisë ndryshonte. Në Shqipëri, BRSS, Republikën Demokratike të Gjermanisë dhe Rumani janë përdorur dënime të ashpra; masat më të lehta kanë qenë në Jugosllavi dhe, në një farë mase, në Poloni, pas viteve 1980. Në RDGJ arratisja konsiderohej krim shtetëror ("dezertim") dhe dënohej nga 1-8 vjet burg. Në Poloni ishte krim penal dhe dënohej nga 1-5 vjet burg. Në BRSS ishte tradhti kombëtare dhe dënohej 10 vjet burg ose vdekje. Në Rumani konsiderohej krim politik dhe dënohej nga 10–20 vjet burg. Në Jugosllavi, në periudhat e hershme konsiderohej krim dhe dënohej 3-10 vjet burg, një masë që pas viteve 1960 u lehtësua. Në ligjet e mëparshme për krimet politike në Shqipëri, si ligji i vitit 1920,<sup>35</sup> ligji i vitit 1925 dhe as në Kodin Penal të vitit 1928, largimi jashtë vendit nuk ishte kriminalizuar, në qoftë se nuk lidhej me ndonjë krim tjetër. Izolimi është përdorur nga shtetet diktatoriale, në përgjithësi, si një mjet në funksion të objektivave

<sup>34</sup> Studim i Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Penale, Nr.35/B, datë 30.12.1986.

<sup>35</sup> F. 255, Viti 1920, Dosja 1399, *Arkivi Qendror i Shtetit*. "Neni 1. Çdo njeri shqiptarë ose i huaj, që ndodhet në tokat shqiptare është i ndaluem për me bë propaganda politike të çfarëdolloj që të jetë me qëllim që të prishi sigurimin e qetësinë e brendshme. Propagandat e ndalueme janë këto që tregohen më poshtë:

a- Propagande kundër kombësisë shqiptare, kundër flamurit kuq e zi me shqiponjë, kundër mvehtësisë shqiptare, kundër gjuhës me shkronja kombëtare.

b-Propaganda që kanë për qëllim të përziemit e fesë kundra politikës kombëtare.

c-Propaganda që sjellin armiqësi dhe ftohtësi midis feve të njohura dhe të nderuara të shtetit shqiptar.

Neni 2 Çdo njeri, shqiptar apo i huaj, që bën propagandat e dëftueme në pikat a, b, c dënohet 3 deri 15 vjet burgim".



strategjikë, kontrolli mbi popullin, mbajtjen larg informacionit nga jashtë, veçanërisht të shteteve demokratike perëndimore, për të rritur efektin e propagandës dhe shpëlarjes së trurit, evitimin e reagimit ndaj dhunës dhe shtypjes, mospërbushjen e detyrimeve lidhur me të drejtat e njeriut, të garantuara nga aktet ndërkombëtare. Lidhur me interpretimin e arratisjeve si tradhti ndaj atdheut, apo liri personale, për një jetë më të mirë dhe për t'i shpëtuar përndjekjes dhe shtypjes së regjimit, apo për t'ju bashkuar pjesës tjetër të familjes që ndodhej jashtë vendit, sigurisht nëse i referohemi folklorit dhe artit muzikor është e qartë se këngët e kurbetit dhe të mërgimit kanë zënë një prej tematikave kryesore. Në këto këngë dhe në të gjitha veprat e artit lidhur me këtë tematikë shprehet dashuria dhe malli për vendlindjen dhe atdheun, ndaj natyrshëm është absurde të mendojmë se mërgimtarët janë tradhtarë të atdheut. Nga ana tjetër duhet të bëhet dallimi ndërmjet atdheut, pushtetit dhe regjimit. Është shumë e rëndësishme të dallojmë se atdheu është populli, kultura, historia dhe gjuha, pra një ide më e gjerë; shteti apo regjimi është forma e organizimit politik të kohës, që ishte diktatorial dhe i imponuar, kryesisht me mjetet e dhunës. Të arratisurit ishin kundër regjimit dhe jo kundër atdheut. Përveç kriminalizimit ekstrem të kalimit të kufirit, si tradhti ndaj atdheut dhe vendosjes së sanksioneve maksimale, u ndërmorën edhe masa të tjera ndëshkuese në funksion të parandalimit të arratisjeve. Një nga këto masa ka qenë internimi i shtetasve të lidhur me personat e arratisur, apo të dyshuar për rrezik arratisje.

Institucioni i internim dëbimit, si masë administrative është rregulluar në bazë të dekretligjit nr. 649, datë 10.1.1949 dhe është ndryshuar më vonë me dekretet nr. 1906, datë 02.08.1954, nr. 3021, datë 12.01.1960, nr. 4137, datë 9.5.1966, si dhe me dekrete të tjera të mëvonshme. Dënimi me internim dhe dëbim u parashikua si dënim gjyqësor edhe në Kodin Penal.

Kriteret për internimin dhe dëbimin si masë administrative, parashikoheshin në ligjet e përmendura më lart dhe rregulloren mbi të internuarit dhe të dëbuarit. Internimi dhe dëbimi janë zbatuar kundër personave që sipas vlerësimit të regjimit paraqisnin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si:

- 1) Pjesëtarë të veçantë ose të gjithë familja e një personi që arratiset jashtë shtetit, kur ajo banon në afërsi të zonës kufitare.
- 2) Mund të internohen edhe një pjesë ose disa pjesëtarë të familjes së një personi që arratiset jashtë shtetit, të cilët banojnë jo në zona kufitare, kur një masë e tillë i shërben parandalimit të arratisjeve të tjera të mundshme nga ajo zonë.
- 3) Elementë antiparti, qëndrimi i të cilëve në vendin ku banojnë bëhet i rrezikshëm.
- 4) Persona të veçantë ose familje të personave që banojnë në afërsi të zonave kufitare dhe që paraqesin rrezikshmëri për t'u arratisur.
- 5) Elementë me tendencë të mprehtë terrori.
- 6) Kundër pjesëtarëve madhorë të familjeve të kriminelëve të luftës që janë arratisur jashtë shtetit, pjesëtarë të personave të tjerë të t'arratisurve jashtë shtetit, kur ata kanë prejardhje klasore reaksionare dhe vetë paraqesin rrezikshmëri. Për të dy këto kategori, kjo masë të merret kur banojnë në qytetet kryesore.

Në raste të veçanta, masa e internim dëbimit mund të merret edhe kundër personave që kanë kryer vepra të tilla keqbërëse si vjedhje, prostitucion, vagabondazh me përsëritje, por kur këta banojnë në qytetet kryesore.<sup>36</sup>

Nga raporti mbi internim dëbimet gjatë vitit 1967, shikohet që janë 1.189 persona si të dënuar me internim dhe dëbim. Nga 1.189 të internuar dhe dëbuar, 496 raportohen të jenë nga shtresa të pasura, 421 ishin shtresa të mesme, 272 janë nga shtresa të varfra, 555 persona janë nga fshati dhe 634 janë nga qyteti. Arsytet e internimit arrihet në përfundimin të jenë: 432 persona kanë pjesëtarë të familjes të arratisur, 105 kanë tendencë arratisje, 288 kanë rrezikshmëri shoqërore, 19 persona antiparti, 285 sjellje të padenjë në shoqëri, vjedhje, kurvëri etj. Në shkallë vendi rezultojnë 270 familje të internuara, nga të cilat 122 nga fshati dhe 148 nga qyteti.<sup>37</sup> Përpjekjet e shtetasve për t'u arratisur intensifikoheshin në rastet e vendosjes së tyre në izolim, burg i mbyllur, kampe me punë të detyruar apo kampe internimi. Thuajse të gjitha këto kategori përbënin kontingjent për institucionet e privimit të lirisë, por me natyrë të ndryshme, nisur nga kushtet e sigurisë, infrastruktura, organizimi i brendshëm, mbikëqyrja, përbërja e popullatës së të burgosurve, ose të internuarve. Në kampe internimi shtetasit vendoseshin bazuar në një procedurë administrative, por jo vetëm, sepse internimi përdorej edhe si dënim plotësues pas kryerjes së atij me burg, ndërsa në burgje dhe kampe personat vendoseshin bazuar mbi një vendim gjyqësor. Në kampet e internimit janë vendosur edhe familjarë dhe fëmijë të subjektit, ndërsa në burgje dhe kampe janë izoluar vetëm subjektet e dënuar. Gjithashtu, koha e vuajtjes së dënimit në kampet e internimit nuk ishte fikse, pasi shumica e subjekteve janë vendosur aty me një vendim për 5 ose 10 vite, por në fakt e kanë kaluar gjithë jetën në internim.

Arratisjet nga burgjet janë një fenomen bashkëshoqërues gjatë gjithë ekzistencës së tyre, të cilat burojnë së pari nga dëshira për liri e personave të izoluar. Arratisjet nga burgjet e Shqipërisë gjatë regjimit komunist (1944–1990) përbëjnë një nga kapitujt më dramatikë të historisë së rezistencës ndaj diktaturës. Këto arratisje ishin akte të guximshme dhe të rrezikshme, që tregonin dëshirën e thellë për liri, përballë një regjimi shtypës dhe brutal. Të burgosurit që u arratisën nga burgjet e regjimit komunist ishin individë me profil psikologjik jashtëzakonisht të fortë, të udhëhequr nga një ndërthurje e guximit, bindjeve të forta dhe dëshirës për liri. Arratisja e tyre nuk ishte vetëm një akt fizik, por edhe një dëshmi psikologjike e rezistencës ndaj shtypjes. Shumë prej të arratisurve ishin të burgosur politikë, me bindje të qarta antikomuniste dhe me një përjetim të thellë të padrejtësive të regjimit. Ata tregonin guxim të jashtëzakonshëm dhe një vullnet të pathyeshëm, për të mos u nënshtruar dhe për të sfiduar kufirin ndërmjet jetës dhe vdekjes. Teknikat e realizimit të arratisjeve flasin për inteligjencë të shkallës së lartë, parapërgatitje shumë të sofistikuar dhe qetësi në sjelljet dhe veprimet e tyre, edhe në situatat më të rrezikshme për jetën. Çdo skenë arratisje është një rast i veçantë, thuajse unik, siç ishte në disa raste rrëmbimi i kamionit dhe largimi me forcë, pak a shumë në ngjashmëri me rastin e viteve 1990 të hyrjes në

<sup>36</sup> Fondi, Kuvendi Popullor (890), D.255,V.1970, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

<sup>37</sup> Fondi Prokuroria e Përgjithshme (492), D. 60,V.1967, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

ambasada, me qëllim për t'u larguar nga vendi,<sup>38</sup> ndërtimi i tuneleve, nga brenda, për të dalë jashtë rrethimit, sulmi fizik mbi rojet etj. Por duhet të theksohet se në asnjërin rast arratisjeve nga burgjet e regjimit komunist nuk është evidentuar që të jetë përdorur forca vdekjeprurëse ndaj punonjësve të administratës, apo të sigurisë. Më datën 9 korrik 1972, dy të dënuar që ndodheshin në dhomat e izolimit të burgut të Tiranës kishin shkruar në muret e qelisë: “Ti i burgosur që dergjesh në këtë qeli, mos ju dorëzo vuajtjeve, se atë që ti pret prej kohësh, - Lirinë, - do ta gjesh vetëm duke patur durim dhe jo ëndrra dhe shpresa”.<sup>39</sup> Arratisjet nga burgjet kanë qenë përpjekje me synim final daljen nga kufiri shtetëror, pra arratisjen dhe për këtë arsye thuajse të gjithë të arratisurit që janë kapur, janë dënuar me dënime të gjata, por edhe me vdekje.

Në kushtet e kontrollit të plotë, të territorit dhe popullatës, për të burgosurit e arratisur ishte absolutisht i pasuksesshëm strehimi për një kohë të gjatë brenda territorit pa rënë në duart e organeve ligjzbatuese, të cilat kishin krijuar një rrjetë të dendur survejimi dhe bashkëpunimi. Arratisjet jashtë shtetit e të burgosurve të arratisur nga burgjet është dëshmi e fortë se pikësynimi kryesor ishte largimi jashtë vendit. Për të burgosurit që ndërmernin të tilla akte sfidat ishin dyfish më të mëdha, sepse duhej kapërcyer rrethimi i burgut dhe rrethimi shtetëror. Rreziku më i madh për çdo të burgosur që ndërmerrte hapin për t'u arratisur nga burgu, ose kampi, ka qenë ekzekutimi nga rojet, ende pa e kapërcyer rrethimin, ose nga strukturat e sigurisë, në përpjekje për t'u larguar. Ekzekutimi i të burgosurve që kanë tentuar të arratisen përbën aktet më tragjike për shumë persona që kanë humbur jetën, por është edhe një rast i pastër i cenimit të së drejtës së jetës pa ligj dhe në mënyrë shumë joproporcionale.

Largimi nga vendi i vuajtjes së dënimit, parashikohej si vepër penale me një sanksion jo më shumë 3 vite burgim, në Kodet Penale të RPSSH<sup>40</sup>, të viteve 1952 dhe 1977, gjë që tregon se masat ekstreme, ekzekutimet, torturat e keqtrajtimi, të kryera nga personeli i burgjeve dhe nga policia, ndaj të burgosurve që janë arratisur apo kanë tentuar të arratisen, përveç se janë veprime joproporcionale, me shkeljet e kryera përbëjnë një krim institucional kundër jetës së personit. Për të argumentuar se ekzekutimet gjatë arratisjeve, apo tentativës për arratisje, kanë qenë në shkelje të ligjit ekzistues, mund të sjellim edhe disa raste megjithëse të izoluara, kur ekzekutorët dhe urdhëruesit e tyre janë ndëshkuar, pavarësisht se ndëshkimet kanë qenë minimale, si ato me punë korrektuese ose dënime më të lehta. Në Kampin e Punës nr.309, më datë 24 gusht 1964, i dënuari E. Xh. u qëllua për vdekje nga ushtari, vetëm sepse u ishte afruar vijave kufizuese të zonës së

---

<sup>38</sup> Më 23 qershor, automjeti Škoda LIAZ, e drejtuar nga Fatos Kaceli, shpërtheu portën e ambasadës italiane, ndërsa të nesërmen, rreth orës 18.00, Škoda e drejtuar nga Kastriot Mano çau mes për mes murit të ambasadës gjermane, duke e shembur atë.

<sup>39</sup> Fondi Kampet dhe Burgjet, V.1971, D 142, *Arkivi Ministrisë së Brendshme*.

<sup>40</sup> Kodit Penal i RSH, i aprovuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.1470, datë 23 Maj 1952, neni 229 “Arratisja e të arrestuarit dhe të dënuarit”: “Arratisja e të arrestuarit nga vendi i ndalimit ose nga burgu, dënohet me heqje të lirisë gjer në tre vjet. Arratisja e të dënuarit me internim nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm ose gjatë udhëtimit për në atë vend, dënohet me heqje të lirisë, baras me kohën e internimit që mbetet për t'u vuajtur. Kthimi i paligjshëm i të dënuarit me dëbim, në vendin ku ishte ndaluar qëndrimi, dënohet me internim ose heqje të lirisë, baras me kohën e dëbimit që mbetet për t'u vuajtur”.

ndaluar në sheshin e ajrimit. Nga të dhënat e dosjes del se ushtari u mbrojt nga komanda lidhur me veprimin e tij kriminal, megjithatë gjykata e dënoi me 4 vite burg.<sup>41</sup> Në nenin 170 të “Rregullores mbi sigurimin dhe trajtimin e të dënuarve në burgje dhe repartet e riedukimit”, botim i vitit 1986, lidhur me arratisjet ose tentativat për arratisje, parashikoheshin këto veprime nga ana e rojës së jashtme: “Kur të dënuarit ose të arrestuarit shkelin zonën e ndaluar, nga ana e brendshme e rrethimit të repartit të riedukimit, burgut, ose frontit të punës (tabelën e ndalimit) roja e sigurimit të jashtëm u drejtohet me thirrjen “NDAL”, “NDAL SE DO TË QËLLOJ” dhe, kur të dënuarit ose të arrestuarit kalojnë tabelën e ndalimit, ajo hap zjarr e qëllon nga këmbët për t’i plagosur dhe, në pamundësi të kësaj, për t’i asgjësuar”.

Siç thamë më lart, qëndrimet ndëshkuese ndaj ekzekutimeve gjatë arratisjeve, apo tentativave, kanë qenë të izoluara, pra në raste të rralla, ndërsa nxitjet dhe madje motivimi i rojeve për ekzekutimin e të burgosurve kanë qenë normë. Ja një rast ilustrues sesi përshkruhet në një informacion me lëndë “Mbi tentativën për arratisje të një të dënuari”, për Ministrin e Punëve të Brendshme Gjeneral-Lejtnant Kadri Hazbiu.<sup>42</sup> Në Repartin nr.307, Rubik, më datë 04.02.1964 tentoi të arratiset nga fronti i punës i dënuari për krime kundër shtetit Hilmi Maliq Lame, i cili u vra nga rojet e rrethimit të jashtëm të sigurimit të të dënuarve në objektin e punës, që në momentin e kalimit të zonës së ndaluar dhe daljen e tij jashtë rrethimit. Asgjësimi i të dënuarit në momentin e tentimit për arratisje, - thuhet ne informacion, - tregon gatishmërinë luftarake të Repartit nr.307 për sigurimin e të dënuarve, organizimin e mirë të shërbimit në bazë të skemës së dislokimit, njohjen dhe zbatimin e *instruktimeve dhe udhëzimeve, vlerësimin e të dhënave agjenturore operative dhe vigjilencën e lartë revolucionare të të gjithë efektivit*. Ky akt u shoqërua me dhënie fletë nderi për komandantin, zëvendëskomandantin për punë politike, si dhe shpërblim financiar për shëfimin e stërvitjes dhe operativin. Në vitin 1972, nga Reparti Nr.303, Spaç, ishte raportuar një tentativë arratisje më datën 23.05.1972, rreth orës 01:<sup>00</sup>, që mbeti e pa suksesshme pasi i burgosuri u kap pas tri ditësh në Pukë, nga forcat vullnetare të një fshati dhe një arratisje tjetër, më datë 12.06.1972, e cila kishte përfunduar me ekzekutimin e të burgosurit. Përfundimi i autoriteteve të repartit ishte se “*po të ishte vrarë i pari, ose të ndalohej, nuk do të kishte marrë iniciativë i burgosuri i dytë, i cili mbeti i vrarë*”.<sup>43</sup> Pra, duke gjurmuar në qindra raste të përpjekjeve të të burgosurve për të shpëtuar nga ferri, arrihet në përfundimin që ndonëse largimi nga vendi i vuajtjes së dënimit ishte parashikuar me dënim deri në tre vite, por në fakt të gjithë të arratisurit e kapur janë dënuar të akuzuar për veprën penale tradhti ndaj atdheut, duke parashikuar se qëllimi i arratisjes nga burgu ishte arratisja jashtë vendit. Një pjesë e madhe e të arratisurve janë ekzekutuar nga rojet, të cilat janë stimuluar dhe inkurajuar për ekzekutimin e të burgosurve të arratisur.

<sup>41</sup> F. Kampet dhe Burgjet, D.133, V.1967, Arkivi Ministrisë së Brendshme.


<sup>42</sup> F. Kampet dhe Burgjet, D.113, V.1964, Arkivi Ministrisë së Brendshme.

<sup>43</sup> F. Kampet dhe Burgjet, D.142, V.1971, Arkivi Ministrisë së Brendshme.

## **Arratisjet nga burgjet, kampet e punës, kampet e internimit dhe vendet e dëbimit, si akt guximi dhe rezistence ndaj regjimit.**

Arratisjet nga kampet dhe burgjet janë të raportuara nga drejtoritë vendore dhe në analizat e punës së Degës së Kampeve dhe Burgjeve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Raportimet janë të shkurtra, pa detaje dhe pa një analizë të ngjarjeve dhe rrethanave. Nga hulumtimi i burimeve të ndryshme evidentohet se raportimet e drejtorive vendore, si dhe ato të Degës së Kampeve dhe Burgjeve, kanë subjektivizëm, që vjen për arsye të nevojës së justifikimit të veprimeve dhe mosveprimeve të komandave të burgjeve, për të qenë të mbrojtur dhe t’iu shmangur një ndëshkimi të mundshëm, por nga ana tjetër edhe për të evidentuar gatishmërinë dhe përkushtimin e komandave të burgjeve. Sigurisht, në raste shumë të rralla kemi patur hetime të thelluara për arratisjet, kur rastet kanë përfunduar me humbje jete. Pra, nga shumë raportime dhe informacione jemi të sigurt se një apo disa jetë kanë humbur, dikush është ridënuar dhe torturuar, por nuk na ofrohet tabloja e qartë, veçanërisht e rolit të komandave para, gjatë dhe pas ngjarjeve të tilla. Raportime të tilla, si dhe mbulimi i të vërtetave, krijojnë vështirësi për të ndërtuar një material shterues për numrin e plotë të arratisjeve, numrin e atyre që janë vrarë, duke u arratisur dhe numrin e atyre që janë ridënuar. Sistemi i burgjeve dhe i kampeve të punës, si dhe kampet e internimit, gjatë regjimit komunist, nuk shquhej për një siguri të lartë fizike, për sa i përket infrastrukturës. Shumica e kampeve kanë qenë ndërtime provizore të lëvizshme, sipas nevojave për forca pune në miniera, bujqësi, ndërtim etj. Kështu, arratisjet pothuajse kanë ndodhur në kampet e internimit, kampet e punës dhe nga fronti i punës, ndërsa nga burgjet kanë qenë shumë të rralla. Kjo situatë e dobët e sigurisë fizike është kompensuar nga funksionimi i veprimtarisë operative të organeve të sigurimit, me degët e punëve të brendshme dhe komandat e burgjeve, të cilat kishin rekrutuar me metoda të ndryshme qindra të burgosur, të cilët sinjalizonin ose bashkëvepronin me komandat. Gjithashtu kontrolli i plotë në shkallë vendi nëpërmjet organeve të sigurimit dhe rrjeta e bashkëpunëtorëve e bënte thuajse të pamundur suksesin e një arratisje nga burgje

Duke parë frekuencat e arratisjeve vërehet se ato kanë qenë më intensive në periudhën nga viti 1945, deri nga fillimi i viteve 1960, për arsye të shumë faktorëve, si mungesa e eksperiencës në administrimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit, numri shumë i lartë i të dënuarve, për kapacitetet e vendit tonë, si dhe në raport me numrin e popullsisë dhe, veçanërisht, mungesa e mjaftueshme e elementëve të sigurisë fizike.



- Më 1950 janë arratisur 20 të burgosur.
- Më 1951 janë arratisur 19 të dënuar dhe 18 nga kampet e internimit.
- Më 1976 kanë ndodhur 5 arratisje.

Në mënyrë kronologjike do të jepen disa prej arratisjeve, duke u bazuar në raportimet e institucioneve shtetërore prej vitit 1945 e në vazhdim gjatë periudhës komuniste.

<sup>44</sup> Planimetria e kampit të punës Laç. F.494, V.1963, D.418, *Arkivi Qendror i Shtetit*.

- 1) Më 23.07.1945 raportohet një arratisje e tetë të burgosurve politikë nga burgu i Peshkopisë, katër prej të cilëve ishin vranë dhe të tjerët ia kishin dalë të arratiseshin. Të arratisurit ishin të dënuar me vdekje dhe ishin në pritje të ekzekutimit. Gjatë arratisjes, në përpjekje me forcat e ndjekjes u vranë edhe të burgosurit e tjerë të arratisur.<sup>45</sup>

Jehonën më të madhe në vitet e para të regjimit komunist kanë bërë dy arratisje nga Kampi i Beratit dhe Kampi i Llakatundit në Vlorë, në vitin 1947.

Në Berat ishte ndërtuar një kamp internimi, ku ishin vendosur familjarë të shtetasve të arratisur nga i gjithë vendi, por nuk kishte vetëm nga kjo kategori të internuarish. Gjatë vitit 1947, kjo ishte gjendja sipas muajve:<sup>46</sup>

| Viti 1947             | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|-----------------------|-------|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|
| Gjithsej të internuar | 855   | 792    | 762  | 770   | 743 | 565     | 575    | 575   | 586     | 571   | 583    | 583     |

Gjithashtu, në Berat funksiononte edhe burgu, që nga koha e paraluftës, në të cilin ishin vendosur të burgosur politikë nga i gjithë vendi. Referuar një statistike të janarit 1951, burgu i Beratit kishte një kapacitet prej 216 vendesh dhe në të ndodheshin të izoluar 489 të burgosur,<sup>47</sup> të cilët aktivizoheshin në punët e bujqësisë.


- 1) Referuar informacioneve bashkëkohore, më datë 17.04.1947, gjatë kohës që po ktheheshin nga fronti i punës për në burg, janë arratisur 20 të burgosur të dënuar për krime politike. Ky informacion jepet nga komanda e burgut dhe drejtuesi i strukturave të partisë në Berat.
- 2) Më 3.12.1947 u realizua një arratisje tjetër nga ferma Llakatund Vlorë, ku punonin 60 të burgosur politikë. U arratisën 9 të burgosur të dënuar me 10-20 vite burgim për krime politike.
- 3) Nga burgu i Kukësit më 29.9.1948 u arratisën dy të burgosur, Hasan Dida dhe Selman Oka i cili u vra.
- 4) Në korrik 1949, nga dhomat e paraburgimit të burgut Nr.5, më vonë i emërtuar Reparti nr.313, arratiset i paraburgosuri Adem Çoku, i cili kapet brenda oborrit të burgut. Nga analiza e komandës vlerësohet se i paraburgosuri është mbështetur nga një nënoficer i cili është kompromentuar.<sup>48</sup>

<sup>45</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: Shtypshkronja Maluka, 2015).

<sup>46</sup> Sufaj, *Historia e burgjeve ë Shqipërisë gjatë shekullit XX*.

<sup>47</sup> Po aty

<sup>48</sup> Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.



49

- 5) Në vitin 1950 në Kampin e Bedenit vritet nga rojet i burgosuri Mustafa Vata, me justifikimin se do te arratisesh, por nuk del qartë se cili ishte motivi vërtetë i vrasjes.<sup>50</sup>
- 6) Nga kampi ku mbaheshin shtetas grekë të krahut forcave qeveritare, të quajtur monarko-fashistë, me datë 6.7.1950 tentuan të arratisen 9 shtetas grekë, të cilët u kapën dhe u dënuan me 3-5 vite burg.<sup>51</sup>
- 7) Referuar në analizat dhe raportet e Degës së Kampeve dhe Burgjeve, në vitin 1950 janë bërë 20 arratisje nga të gjitha burgjet dhe kampet e punës dhe ato të internimit. Nga Burgu i Durrësit janë arratisur katër të burgosur, nga Kampi i Punës Ura e Bonës, Peqin, Bishqem janë arratisur 6 të dënuar, nga kampet e internimit Valias, Tepelenë, dhe kampi i robërve Sukth janë arratisur 6 të dënuar. Të arratisurit nga kampi i internimit ishin kapur, ndërsa njëri është qëlluar dhe është gjetur pas 30 ditëve i vdekur në një pyll.

<sup>49</sup> Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit. *Kujto.al*.

<sup>50</sup> Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*

<sup>51</sup> Po aty.



- 8) Gjatë vitit 1951 kanë ndodhur 19 arratisje, nga të cilat 13 nga të dënuar politikë dhe 6 nga të dënuar ordinerë. Nga të arratisurit, njëmbëdhjetë nuk janë kapur. Arratisjet janë kryer nga Kampi nr.1 Maliq, në katër raste, me 7 të dënuar në total, nga Kampi nr.2, në dy raste, me tre të dënuar, nga Kampi “Stalin” një i dënuar, nga Kampi Ofiçina e Ministrisë së Brendshme dy të dënuar, nga burgu i Shkodrës tre të dënuar, nga burgu i Tiranës dy të dënuar, në Burgun Berat një i dënuar. Me datë 10.7.1951 ishin arratisur nga ky kamp të dënuarit: Ylvi Feim Prodani, Musledin Glina, Ferit Abedini, të cilët u arratisen jashtë shtetit.
- 9) Nga kampet e internimit ishin arratisur 18 veta, nga të cilët janë kapur 10. Arratisjet kanë ndodhur në Kampin e Tepelenës, 14 shtetas, në Kampin Valias dy dhe në Kampin e Robërve Grekë dy. Një prej të arratisurve nga Kampi i Tepelenës, ishte Sazan Dema, i biri i Hysni Demës, ish komandant i xhandarmërisë. Sazani arrin të shkojë në Tiranë tek e motra, por riarrestohet dhe dënohet me 4 vite burgim. Pas daljes nga burgu ai arratiset dhe mbërrin në Amerikë.
- 10) Më 21.08.1952, nga Kampi Punëtorja e Artizanatit në Tiranë u arratis i dënuari Kolec Pikolini, bashkë me një shokun e tij.<sup>52</sup>
- 11) Në datën 31.10.1953, ora 03:00, pas mesnatës, u arratisën nga kampi Nr.1 në Kamëz 4 të burgosur politikë, të cilët megjithëse u qëlluan nga rojet nuk u ndaluan. Arratisja e tyre, raportohet se është shkaktuar nga moskontrolli i mirë prej komandantit dhe punëtorit operativ, të cilët nuk kanë mundur të kuptojnë përgatitjet e të burgosurve që kanë punuar 15 ditë dhe kanë hapur një tunel 12 metra të gjatë dhe një metër të gjërë. Tuneli ka filluar nga kanalet e ujrave të zeza dhe ka dalë dy metra jashtë rrethimit perimetrik. Nga hetimi i kryer ishte konstatuar se veglat e punës janë mbajtur në ambjentet e banimit brenda në kabanone. Të arratisurit mundën të iknin jashtë shtetit.<sup>53</sup>

Të arratisurit kishin këto identitete dhe këtë gjendje gjyqësore:

- a. Abaz Vesel Korçari, nga Vërzështa e Skraparit, lindur në vitin 1924, nëpunës. U arrestua më 16.8.1946. U akuzua në bazë të nenit 15 të ligjit nr.41, datë 15.1.1945 dhe nenit 1 të ligjit nr.21, datë 15.12.1944. U dënua në grup. Gjykata Ushtarake Berat, me vendimin nr.427, datë 19.11.1946 e deklaroi fajtor dhe e dënoi me vdekje dhe konfiskim të pasurisë. U ndryshua me burgim të përjetshëm me vendimin nr.174, datë 3.12.1946 të Gjykatës së Lartë Ushtarake.
- b. Ago Çelo Hitaj, nga Bolena e Vlorës, lindur më 1929. U arrestua më 29.8.1949. U akuzua në bazë të nenit 4/1 të ligjit nr.372, datë 12.12.1946. U dënua në grup. Gjykata Ushtarake Gjirokastrë, me vendimin nr.90, datë 4.6.1950, e deklaroi fajtor dhe e dënoi me 12 vjet privim lirie dhe heqjen e së drejtës zgjedhore, për 3 vjet.

---

<sup>52</sup> Po aty.

<sup>53</sup> Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D.30, V.1953, *Arkivi i Ministrisë së Brendshme*.

- c. Shefqet Nexhip Ismailaj, nga Kardhiqi i Gjirokastrës, lindur më 1920. U arrestua më 24.5.1948. U arratis, por u kap më 21.12.1948. U akuzua në bazë të neneve 2, 3 (1, 8), 4, 8 të ligjit nr.372, datë 12.12.1946. Gjykata e Lartë Ushtarake me veprim në Vlorë, me vendimin nr.201, datë 25.11.1949 e dënoi me 15 vjet privim lirie, punë të detyruar, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e së drejtës zgjedhore për 5 vjet.
- d. Nexhip Sherif Dauti, nga Palavlija e Delvinës, lindur në vitin 1924. U arrestua më 20.11.1950. U dënua në grup. U akuzua në bazë të nenit 4/1 të ligjit nr.372, datë 12.12.1946. Gjykata e Lartë Ushtarake me veprim në Gjirokastrë, me vendimin nr.302, datë 27.11.1950, e dënoi me 20 vjet privim lirie, punë të detyruar, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e së drejtës zgjedhore për 5 vjet.<sup>54</sup>

12) Në vitin 1952, nga Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, ku mbahej i ndaluar në pritje të gjykit, arratiset një i paraburgosur i dyshuar si diversant, me ndihmën e rojës Gani Kasa, të cilët u arratisën bashkë dhe ranë në përpjekje me forcat e ndjekjes në Bizë, një fshat i Tiranës, nga ku i arrestuari u vra dhe polici u gjykua, u dënua me vdekje dhe u ekzekutua.<sup>55</sup>

13) Në vitin 1953 raportohet një arratisje tjetër nga Burgu i vjetër i Tiranës, që më vonë u bë Reparti nr.313, i cili ishte nën administrimin e Drejtorisë së Burgut Nr.5. I paraburgosuri Kol Pulti u arratis duke hequr tullat e murit me mjete rrethanore, çka u kuptua një ditë më pas, kur nga rojet e jashtme u vu re vrima që ishte hapur në mur. I paraburgosuri u arrestua në Milot dhe u dënua me pushkatim.<sup>56</sup>

14) Në vitin 1954 ishte planifikuar një arratisje e disa të dënuarve nga Kampi Nr.4 në Tiranë, që ndodhej i dislokuar këtu për ndërtimin e pallateve. Plani u zbulua, për çka disa të burgosur u dënuan me vdekje dhe dënime të gjata. Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.189, datë 17.7.1954, në një seancë të mbyllur, i vlerësoi fajtorë të akuzuarit, duke dënuar:

me vdekje Isuf Agollin, Zydi Mancakun, Abdulla Bajramin, Mark Zef Palin, Besim Latifin, Niko Malon dhe Nasuf Gjilajn; me 25 vjet burgim Emin Bakallin, Xhemal Limanin, Haziz Xhika, Abdyl Kërlukun; me 20 vjet burgim Qani Mulita, Ali Çollakun, Xhemal Suta, Haki Kason, Kolë Pepën; me 15 vjet Stefan Gjora; me 17 vjet Haki Ismailin dhe me 8 vjet Feim Imerin. Vendimi me vdekje u zbatua vetëm për të dënuarit Isuf Agolli, Zydi Mancaku, Abdulla Bajrami dhe Mark Zef Pali. Të tjerëve iu kthyer me burgim. Ky informacion nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundime objektive, për arsye të mungesës së burimeve alternative të informacionit.

---

<sup>54</sup> “1953/Arratisja e katër të burgosurve nga Kampi nr.1 Rinas,” Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, <https://kujto.al/1953-arratisja-e-kater-te-burgosurve-nga-kampi-nr-1-rinas/>.

<sup>55</sup> Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.

<sup>56</sup> Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.

- 15) Në Kampin e Fushës së Aviacionit Berat (kampi nr.1) më 1953 janë arratisur 3 veta, nga të cilët njëri arriti të ikte, tjetri, i cili ishte i burgosur politik, është vlarë dhe i treti është kapur. Arratisjet kanë ndodhur në kohë të ndryshme.
- 16) Më 23.11.1954, nga Gjykata Ushtarake Gjirokastrë dënohen 7 të burgosur politikë të Kampit Shtyllas, Fier, të dislokuar aty për hapjen e kanalit vaditës Vjosë-Levan-Fier. Akuzat ishin për tentativë arratisje dhe dënimet shkonin, nga 8 vite, deri në 25 vite burgim. Tentativa ose largimi nga vendet e vuajtjes së dënimit dënohej deri në tre vite burgim, por, edhe pse nuk arritën ta realizojnë arratisjen, madje duke mos iu afruar as perimetrit të sigurisë, dënimet u janë dhënë kaq të rënda sepse të dënuarit janë paragjykuar, duke e trajtuar arratisjen sikur do të bëhej për t'u arratisur jashtë shtetit. Për këtë prokuroria dhe gjykata nuk kishte asnjë provë, por mund të jenë marrë deklarime me anë të dhunës dhe torturës, gjë që ka qenë praktikë nga organet hetimore.<sup>57</sup>

Nga raporti vjetor i vitit 1956 mbi gjendjen në kampe dhe burgje, raportohen këto arratisje:

- 17) Janë arratisur dy të burgosur nga Kampi i Bulqizës, një nga Kampi Zadrinë dhe një nga Burgu i Tiranës.<sup>58</sup> Nga Kampi i Zadrinës i burgosuri u arratis duke shfrytëzuar barin e gjatë mbi 60cm, i cili pamundësonte vëzhgimin nga ana e rojeve. Nëpërmjet raportit vjetor të Degës së Kampeve dhe Burgjeve të vitit 1956,<sup>59</sup> vjen informacioni se në Kampin e Bulqizës janë arratisur katër të burgosur, nga të cilët dy u kapën në tela dhe dy u arratisën në Greqi. Një nga të burgosurit hyn në kabinën elektrike dhe pret dritat, duke bërë të mundur që të realizohet në errësirë dhe në shi arratisja e 4 të burgosurve. Të arratisurit ishin Isuf Selenica, Nazmi Metollari dhe Shaban Doçi.
- 18) Në vitin 1957 një i dënuar tentoi të arratiset nga Kampi i Bulqizës nr. 301, por u vra në tela dhe për këtë ushtari u gradua “për gatishmërinë dhe vigjilencën e treguar”. Vendndodhja e Kampit të Bulqizës në afërsi të kufirit, natyrisht që ishte një pozicion i favorshëm për të dënuarit guximtarë, pasi nëse ia dilnin të arratiseshin nga burgu, duheshin vetëm disa orë për të kapërcyer kufirin. Rastet e disa arratisjeve të përmendura janë bindëse për të kuptuar se destinacioni kryesor i të arratisurve nga burgjet ishte kapërcimi i kufijve shtetërorë.

---

<sup>57</sup>Harta e kujtesës: Nexhi Ago Nexha (1930) nga Nivica, i dënuar me 21 vjet burg për arratisje, në vitin 1950. Syrja Toto Zenelaj (1930) nga Kuçi, i dënuar me 25 vjet burg për arratisje, në vitin 1949. Maksut Mustafa Kalemaj (1921) nga Koculi i Vlorës, i dënuar me 22 vjet burg për shitje bereqeti, në vitin 1951. Muharrem Bektash Llanaj (1912) nga Levani i Tepelenës, i dënuar me 25 vjet burg për agjitacion. Duke Ramadan Gremi (1933) nga Belini i Fierit, i dënuar me 12 vjet burg për strehim kriminelësh, në vitin 1950. Dhimitër Andrea Zanjoti (1925), lindur në Korfuz, ardhur si emigrant grek në vitin 1949, i dënuar me 10 vjet burg për arratisje. Kristo Jorgji Aleksi (1924), lindur në Janinë, demokrat grek (komunist), i dënuar me 8 vjet burg pse kish dashur të arratisesh. U shpall i pafajshëm Serafinos Kosta Safo (1917), lindur në Vollos, grek i internuar. Shih “Harta e madhe e vuajtjeve të një vendi të vogël,” Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, <https://kujto.al/harta-e-madhe-e-vuajtjeve-te-nje-vendi-te-vogel/>.

<sup>58</sup> Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D.47, V.1956, *Arkivi i Ministrisë së Brendshme*.

<sup>59</sup> Po aty.

- 19) Në Burgun e Tiranës, një i burgosur me masë disiplinore, i vendosur në një ambient të pasigurt, jashtë rrethimit të rojeve, mundi të hapë tavanin dhe nga çatia të varet poshtë në një lartësi dy kate dhe të arratiset.
- 20) Në burgun e Vlorës, në vitin 1956, një i burgosur mundi të arratiset pasi kishte hipur në një ulli dhe hidhet matanë murit rrethues. Rojet e burgut nuk hapën zjarr, kështu i burgosuri realizoi arratisjen.<sup>60</sup>
- 21) Në vitin 1956, nga dhomat e izolimit të Repartit 313 (burgu i ri) arratiset i paraburgosuri Rexhep Gila. Arratisja u vu re të nesërmen në mëngjes nga komanda, ku pas organizimit të operacionit të ndjekjes, i burgosuri u arrestua përtej lumit të Tiranës, në afërsi të Krujës.<sup>61</sup>

Në një historik të shkurtër të Kmpit nr.309, të shkruar në vitin 1967, janë përshkruar në mënyrë kronologjike këto ngjarje dhe arratisje.

- 22) Në Prill 1957, në kampin e robërve grekë, organizohet një revoltë e shprehur në grevë urie për arsye se kërkonin riatdhesimin në Greqi. Praktikë e administrimit të situatave të tilla ishin të dhunshme, duke i prangosur, dhe 10 të tjerë u ridënuan përsëri me dënime të ndryshme.
- 23) Në korrik të vitit 1957 i dënuari H. N. tentoi të arratiset dhe të godasë policin me mjetet e punës.
- 24) Në gusht të vitit 1958, po në këtë kamp, dy të dënuar, Ilija Iljadhi dhe Mehmet Amza, duke konstatuar qëndrimin e pakujdesshëm të ushtarit që kishte lënë armën dhe nuk ishte i vëmendshëm, u arratisën. Por dy të dënuarit u panë nga një nxënës shkolle në fshatin Cullinjë Krujë, që njoftoi organet e pushtetit lokal të cilët bënë rrethimin dhe me forcat vullnetare i kapën. Dy të arratisurit kishin qëndruar në një pellg me ujë të zhytur për orë të tëra, duke marrë frymë nëpërmjet një kallami.
- 25) Në gusht të vitit 1960 i dënuari A. Sh. tentoi të arratiset, por u plagos dhe u kap.

Administrimi i të dënuarve është bazuar kryesisht në punën agjenturore, pra në kontrollin dheurvejimin e të dënuarve, duke rekrutuar të dënuar si bashkëpunëtorë. Në raportin e vitit 1959 të Degës së Kampeve dhe Burgjeve thuhet se “aktiviteti armiqësor në kampe e burgje është përqendruar në agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, me tendencë arratisje dhe organizimi. Elementët që zhvillojnë këtë aktivitet janë kryesisht të prejardhur nga organizata kundërrevolucionare, si ballistë, zogistë, pjesëtarë të Ballit, independentë dhe element të tjerë.”<sup>62</sup> Për të zbuluar dhe shpartalluar këtë veprimtari, përveç masave agjenturore operative që janë marrë nga organet e sigurimit të shtetit, kemi marrë masa për transferimin e të dënuarve, nga Reparti 309 Thumanë, për në Burgun e Burrelit, të Tiranës dhe të Vlorës. [...] Në këtë mënyrë

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.

<sup>62</sup> Fondi Dega dhe Kampeve Burgjeve, D.80, V.1960, *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme*.

kemi mundur të parandalojmë punën e elementit armik. [...] Një punë e mirë është bërë në studimin e bashkëpunëtorëve që janë nëpër kampe e burgje; në bashkëpunim me degën dhjetë kemi bërë transferimin e tyre. Në këtë mënyrë është kontrolluar veprimtaria e elementit armik dhe janë shpërndarë ata që kanë patur tendenca arratisje”.<sup>63</sup> Edhe në raportin e vitit 1962 ngrihet i njëjti shqetësim nga ana e administratës së burgjeve. Në raportin me titull “Veprimtaria armiqësore nëpër burgje”, thuhet: “Përfaqësues të Ballit, Legalitetit, Socialdemokracisë, të dënuar për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, po e paraqesin situatën të paqëndrueshme, gjendjen ekonomike të vështirë dhe aludojnë se do të ketë ndërhyrje nga jashtë. Po nxisin arratisje, duke thënë se kalimi jashtë kufijve të atdheut do u krijojë kushte për një luftë efikase kundër pushtetit popullor”.<sup>64</sup> Numri i atyre personave që konsideroheshin kontingjente të rrezikshme për sistemin nuk ishte i vogël, madje komandat ishin të frikësuara për situata të vështira dhe për sigurinë e bashkëpunëtorëve, të cilët në momentin kur zbuloheshin rriheshin nga të burgosurit.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për efektivitetin e ulët që kishte tek të burgosurit propaganda e bërë nga organet përkatëse, një rëndësi e veçantë i ishte kushtuar punës operative dhe agjenturore. Në një material përmbledhës për “historikun e repartit 309”, në vitin 1967, shkruhet midis të tjerave se në kamp ishte krijuar një gjendje e rëndë nga veprimtaria armiqësore e të dënuarve. Janë marrë masa duke goditur e shpartalluar katër grupe që vepronin aktivisht në kamp. Disa nga krerët e krupëve, si Pjetër Arbnori, P.V e të tjerë janë mbyllur në burgun e Burrelit, të tjerë janë dërguar në kampe të tjera.<sup>65</sup> Për arsye të mos përhapjes së pakënaqësisë për regjimin dhe për të mbajtur sa më të izoluar çdo mendim që ishte kundër sistemit, si dhe për arsye të një trajtimi të veçantë, të burgosurit politikë janë mbajtur të ndarë nga ata ordinerë. Përzierja e tyre mund të bëhej vetëm për arsye të veçanta dhe mungesë hapësirash. Kjo ndarje argumentohej në këtë mënyrë nga administratorët e burgjeve: “Duke qenë se nëpër burgjet tona kemi shumë elementë armiq të klasës, me mentalitete të mykura, si në burgjet për armiq të popullit dhe ata ordinerë, - thuhet në raportin e vitit 1950, - ky dikaster ka vendosur ndarjen e tyre sipas këtyre kategorive: Të dënuarit më vete, nga të paraburgosurit, ushtarakët dhe të rinjtë”.<sup>66</sup> Për të minimizuar rrezikun e ndikimit të dënuarve me krime dhe qëndrime të ndryshme mbi njëri-tjetrin, ishte parashikuar një klasifikim shumë i hollësishëm i të dënuarve, por që ishte i pamundur për t’u zbatuar në praktikë, pasi mungonin hapësirat e mjaftueshme. Në kushtet kur të burgosurit qëndronin në kapononë ose fjetore të mëdha, deri në qindra persona bashkë, ndikimi ishte i paevitueshëm.

26) Më 23 gusht 1961 u arratisën nga fronti i punës tre të dënuar, dy prej të cilëve u kapën dhe njëri u vra. I dënuari Mark Frrok Nikolla ishte ai që mbeti i vrarë, ndërsa Latif Hamja e Nikoll Syziu, ishin ata që u kapën dhe u ridënuan.


<sup>63</sup> Fondi Dega e Kampeve e Burgjeve, D.71, V.1959, *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme*.

<sup>64</sup> Fondi Dega e Kampeve e Burgjeve, D.80, V.1962, *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme*.

<sup>65</sup> Fondi Dega e Kampeve e Burgjeve, D.45, V.1965, *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme*.

<sup>66</sup> Fondi Dega e Kampeve e Burgjeve, D.10, V.1950, *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme*.

- 27) Më 19 nëntor 1963 u arratisën përsëri tre të dënuar: Demir Shkoza, i cili u dënua me vdekje, Ahmet Hoxha, i cili u dënua me 25 vjet dhe Kujtim Aliaj, që u dënua me 25 vjet. Për kapjen e të arrestuarve, u vu në lëvizje i gjithë populli i Mirditës, Burrelit dhe Krujës. Të tre të arratisurit u kapën. Njeri prej tyre kishte kërkuar strehim në një familje, e cila e strehon të arratisurin në ahur të bagëtive dhe më pas e denoncon dhe kapet nga organet e policisë.
- 28) Në vitin 1963 arratisen nga Reparti nr.303, i dislokuar në Tiranë, katër të burgosur.
- 29) Më 15 qershor 1964 në këtë kamp u vra nga roja, në tentativë për arratisje, i burgosuri Mustafa Alushi dhe më 9 maj 1965, kur kampi ishte i dislokuar në Fushë-Krujë, u plagos në tentativë për arratisje i dënuari Uran Kostreci.<sup>67</sup>
- 30) Më 23 prill 1964, në kohën kur në kamp kishte ardhur makina e furnizimit dhe drejtuesi i mjetit po bënte dorëzimin e faturave, një i dënuar hipën në automjet, godet portën dhe largohet. Pas një udhëtimi të shkurtër makina i del nga rruga dhe i burgosuri dorëzohet duke deklaruar se është i dënuar padrejtësisht.



68

- 31) Në nëntor 1965 arratiset një i dënuar tjetër, duke u kapur nën shasinë e kamionit, por u vra tek ura e Bahçallëkut, Shkodër, nga polici i cili po i kërkonte dokumentin e identifikimit. Trupin e të vrarit 25-vjeçar e kthyen përsëri në mes të kampit, për presion ndaj të dënuarve. I dënuari guximtar ishte Mark Cuf Marku. Plani i arratisjes ishte shumë i menduar dhe funksionoi. Brenda portës së repartit ishin dy kamionë njëri pas tjetrit, në pritje të kontrollit nga roja e portës. I dënuari ishte kapur nën shasinë e kamionit të dytë, ndërkohë kur roja po kontrollonte kamionin e parë. Kur roja kalon të kontrollojë kamionin e dytë, i dënuari me kujdes zvarritet poshtë makinave dhe kalon tek kamioni i parë. Kështu arratisja u realizua pa u vënë re nga rojet dhe as nga drejtuesit e mjeteve.

<sup>67</sup> Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*.

<sup>68</sup> Kastriot Dervishi, "Historia -Tentoi të arratisesh, por vuajti 32 vite burg në diktaturë," Lapsi.al, <https://lapsi.al/2018/11/05/historia-tentoi-te-arratisesh-por-vuajti-32-vite-burg-ne-diktature/>.

- 32) Në vitin 1965, nga Reparti 313 tenton të arratiset përpara ekzekutimit i dënuari me vdekje, Rexhep Jerija, por u asgjësua nga rojet në çatinë e burgut.<sup>69</sup>
- 33) Më 17 shtator 1965 komanda e repartit nr.313 raporton një tentativë arratisje nga 5 të dënuar për krime kundër shtetit, të cilët janë zbuluar nëpërmjet agjenturës. Të burgosurit ishin Zydi Topi, Pandi Gollaçi, Nikolla Burgaj, Halit Hymetllari dhe Namik Zeneli.
- 34) Më 3 janar 1966, i dënuari Kiço Budo, duke marrë rrobat e shpërndara në oborr, futet në zonën e ndaluar dhe kalon drejt telit, ku nga ana e rojës paralajmërohet, qëllohet dhe plagoset.
- 35) Në vitin 1966, në Repartin e Fushë-Krujë arratiset i dënuari Ylli Tabaku, bashkë me të dënuarin Maksut Xhomaka. Ylli ishte arratisur më parë nga kampi i internimit dhe kishte tentuar të arratiset jashtë shtetit, pasi të gjithë anëtarët e familjes dhe babin i kishte të dënuar. Arratisja u realizua me anë të një kamioni që ndodhej brenda ambienteve të repartit, gjatë kohës që do të dilte. Gjatë hetuesisë, situatën e vështirë, dënimet, torturat nga policët dhe Sigurimi, Ylli i ka transmetuar nëpërmjet një rrëfimi të plotë.
- 36) Më 3.12.1966, tre të dënuar, Sazan Hadëri, Naun Kondakçiu dhe Murat Marta, rrëmbyen makinën që ishte brenda në kamp dhe thyen postbllokun, duke ecur me shpejtësi, por pa sukses, sepse makina u fiket dhe të dënuarit u larguan në këmbë. Naun Kondakçiu u vra jashtë rrethimit, ndërsa dy të tjerët u kapën dhe u ridënuan. Në tërësi arratisjet nga burgjet gjatë regjimit komunist ishin akte të jashtëzakonshme guximi, të kryera nga individë të vendosur që kishin marrë parasysh edhe vdekjen. Shumë prej tyre kanë bërë disa tentativa dhe, ndonëse janë kapur, nuk janë tërhequr nga planet e tyre.
- 37) Në vitin 1967, nga Reparti nr.313 ndodhin dy tentativa arratisje në kohë të ndryshme, në momentin kur të burgosurit ishin për trajtim shëndetësor në Spitalin e Mushkërive Sauk, Tiranë. Të arratisurit ishin Ahmet Sopot, i dënuar për tentativë arratisje me 10 vite burgim dhe një i dënuar tjetër për vrasje, i cili gjatë kohës që do të zbriste nga automjeti shoqërues u shpëputet rojeve dhe largohet, por arrestohet pas 200 metra.
- 38) Më 26.2.1969, nga Pavijoni 7, spitali i të dënuarve, tenton të arratiset i dënuari Kristaq Çerepi, por u ndalua nga rojet.
- 39) Në kohën kur Reparti nr.309 ishte dislokuar në Ballsh, më 13 shtator 1974, ora 15<sup>30</sup>, i dënuari Durim Zylfo Veleli largohet nga vendi i punës dhe duke u maskuar sipas terrenit kalon një kanal e del nën telin e rrethimit të frontit të punës. Qëllohet nga dy drejtime prej rojeve të frontit të punës dhe mbetet i vrarë.
- 40) Më 12 maj 1975, pesë të dënuar që ishin në dhomat e izolimit (regjim burgu) kishin punuar për më se një muaj për hapjen e një tuneli 12 metra të gjatë dhe 1,5 metra të thellë në dyshe. Si rezultat i kësaj, 4 prej tyre u arratisën, ndërsa i pesti nuk mundi, pasi dëgjoi alarmin që dha roja i sigurimit të jashtëm. Të dënuarit u kapën më pas.
- 41) Në Repartin nr.303 Spaç, më 17 qershor 1968, të dënuarit u orvatën të ndërtonin një tunel për t'u arratisur, por nuk mundën ta realizonin.

<sup>69</sup> Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.

- 42) Gjatë vitit 1969 ishin orvatur për t'u arratisur 15 persona, prej të cilëve gjashtë ishin kapur menjëherë ose asgjësuar, ndërsa nëntë të tjerët ishin kapur në 1-8 ditë. Nga studimi i rasteve dilte se në shumicën e tyre të burgosurit kishin zgjedhur kohën e keqe, me mjegull, shi dhe borë, pasi kishin studiuar më parë kushtet e rojeve. Arratisjet vinin gjatë ndërrimit të turneve, apo nga galeritë e minierës.
- 43) Në datën 8.9.1973, nga reparti 303 Spaç tenton të arratiset i burgosuri Ylli Ahmeti, i cili plagoset nga ushtari dhe lihet për disa orë në tela.<sup>70</sup>
- 44) Në vitin 1975, nga Reparti nr.303, Spaç, ishin arratisur dy të burgosur, të cilët mbetën të vrarë.
- 45) Arratisjet nga kampi mund të bëheshin vetëm në çaste pune, nëpërmjet galerive të shkurtra. Kështu, më 9.12.1977, të dënuarit Stavro Guxo dhe Manol Qirici realizuan një arratisje pa asnjë lëndim, duke mos u vënë re nga rojeve të kampit.
- 46) Më 10.10.1978 arratisen nga Reparti Nr.303, Spaç, të burgosurit politikë Ahmet Hoxha dhe Sali Çako. Pas pesë ditësh të arratisurit arrijnë deri në zonën e Fushë-Alisë në Dibër, ku edhe kapen nga forcat e ndjekjes. Më 1.12.1978 Ahmet Hoxha deklarohet fajtor për krimin e "tradhtisë ndaj atdheut", në bashkëpunim me Sali Servet Çakon dhe dënohet me vdekje me pushkatim. Ekzekutimi i tij kryhet në datën 31 janar 1979. Ahmet Hoxha ishte dënuar edhe dy herë të tjera, më 1958 për arratisje dhe më 1963 për arratisje nga kampi, përkatësisht me 20 dhe 25 vite burgim. Të arratisurit nga burgu, nëse do të ishin larguar të vetëm nga zona e kampit, në mënyrë apriori akuzoheshin edhe për tentativë arratisje jashtë vendit, duke ua klasifikuar veprën penale, nga largim prej vendit të vuajtjes së dënimit, që dënohet deri në tre vite burgim, në arratisje, që përbente tradhti ndaj atdheut. Kështu dënimi jepej me ekzekutim dhe në raste më të mira me 15-25 vite burgim.
- 47) Më 11.6.1979, në tentativë arratisje është vrarë i dënuari Refik Beqo.
- 48) Më 16.10.1982 ushtarët vranë në përpjekje për t'u arratisur të dënuarin Hysen Merdani, i dënuar për arratisje dhe tri ditë më vonë Rexhep Goçin, i dënuar për agjitacion. Ish-bashkëvuajtjesi B. Blloshmi e përshkruan në këtë mënyrë aktin tragjik të vrasjes së Rexhep Goçit: "Të nesërmen, më 16 nëntor 1982 Rexhep Goçi do të jepte shpirt tek galeria 15/1 nga breshëritë e kallashnikovit. [...] Në brendësi të hapësirës, nga rrethimet dhe 20-25 metra larg galerisë ishin vendosur disa tabela në formë trekëndëshash (prej hekuri), tek të cilat i dënuari nuk duhet të kalonte dhe as të afrohej. Rexhepi, disa metra larg këtyre tabelave, po ngarkonte trupat e betonit për t'u futur në galeri. Në këtë kohë u dëgjua ushtima e automatikut, ne shtangëm të gjithë sa ishim nga frika. Sapo u dëgjua zhurma vdekjeprurëse, polici doli e i bërtet ushtarit: - Ç'bëre more, ndaloje zjarrin!
- 49) Nga Reparti 315, Belsh, Elbasan, në vitin 1966 ishin arratisur tre të dënuar të organikës së punës, të cilët u kapën nga forcat e policisë.

---

<sup>70</sup> Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*.



50) Më 2 gusht 1967 në Burgun e Burrelit ndodhi një prej arratisjeve më të pabesueshme për sigurinë e këtij burgu. U arratisën të burgosurit Adem Allçi, Dhori Grijoti dhe Sazan Hadëri. Ky i fundit u vra, ndërsa dy të tjerët u kapën.

Duke analizuar një statistikë të hartuar në Drejtorinë e Kampeve dhe të Burgjeve, në vitin 1979, jepet kjo situatë e rendit dhe e sigurisë në Repartet e Riedukimit, në vitet 1976-1979.

| Viti                 | Ngjarje gjithsej në reparte | Masa penale për të dënuar | Masa disiplinore për të dënuar | Arratisje jashtë shtetit | Largime nga vendet e ndalimit dhe fronti i punës | Të kapur nga organet tona dhe populli | Të ridënuar | Të këshilluar | Zbulime të bëra nga qeni i shërbimit |
|----------------------|-----------------------------|---------------------------|--------------------------------|--------------------------|--------------------------------------------------|---------------------------------------|-------------|---------------|--------------------------------------|
| 1976                 | 1069                        | 41                        | 2010                           | -                        | 5                                                | 5                                     | 41          | 270           | 1                                    |
| 1977                 | 1435                        | 37                        | 1420                           | 1                        | 10                                               | 9                                     | 37          | 199           | -                                    |
| 1978                 | 1258                        | 48                        | 2824                           | -                        | 5                                                | 5                                     | 48          | 206           | 1                                    |
| 6-mujori i parë 1979 | 757                         | 50                        | 1519                           | -                        | 4                                                | 4                                     | 50          | 120           | -                                    |
| Shuma                | 4499                        | 176                       | 7773                           | 1                        | 24                                               | 23                                    | 176         | 785           | 2                                    |

Nga analiza e të gjitha rasteve që u paraqitën në këtë trajtesë, rezulton se janë arratisur afërsisht 226 të burgosur, janë vrarë 28 dhe nuk janë kapur 77. Të tjerët janë kapur dhe dënuar me dënime të gjata dhe me vdekje. Besohet se numri i të burgosurve të arratisur është më i madh, por mungesa e dokumentacionit na vendos në pamundësi për të dhëna përfundimtare.

### **Arratisjet si akte të montuara nga komandat, për të shtuar kontrollin dhe frikën mbi të burgosurit.**

Shumë ngjarje të ndodhura në burgje dhe kampe kanë qenë rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të komandave, të cilat kanë përdorur edhe mjete të paligjshme dhe arbitrare në funksion të kontrollit dhe ruajtjes së rendit e sigurisë. Përdorimi i dhunës dhe torturave është konsideruar si mjet i zakonshëm dhe normal për ndëshkime të të burgosurve, kryesisht gjatë fazës hetimore, por edhe më vonë, për mosbindje, për marrje informacioni, për bashkëpunim, për mosrealizim të normave të punës etj. Në strukturat organike të komandave të burgjeve dhe kampeve ka patur punonjës të sigurimit, të cilët quheshin punëtorë operativë. Ata kanë bashkëpunuar me komandat në funksion të parandalimit dhe punës zbuluese operative, duke krijuar rrjetin e bashkëpunëtorëve brenda burgut, të cilët, nisur nga motive personale ose qëllime përfituese, mund të sajnin akuza të pavërteta ndaj një të burgosuri, duke e bërë atë shënjestër të organeve të sigurimit, deri në eliminim fizik. Rasti i ndodhur në Kampin nr.301, Bulqizë, në vitin 1957, është një rast i pastër manipulimi dhe keqpërdorimi të autoritetit, me pasojë humbjen e jetës së të burgosurve. Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresë nr.1374, datë 1.8.1968,<sup>71</sup> i

<sup>71</sup> Fondi 492, D 66, V.1969, Arkivi Qendror i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme.

ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme denoncimin e qytetarit Sulejman Haxhia, ish kryeinfermier në kampin e Bulqizës, ku thuhet se gjatë vitit 1957 janë kryer disa krime:

- *Kanë vrarë në pritë të burgosurin Hysen Rakip Sadikaj.*
- *Ka vdekur në tortura i burgosuri Seit Myrto.*
- *Është hedhur në një oxhak galerie i burgosuri Musa Ismaili.*

Janë pyetur 29 persona dhe nga organet e hetuesisë është provuar se është kryer krim kundër të dënuarve, me bashkëpunimin e stafit. Për këtë është marrë i pandehur për vrasje me dashje Hazbi Lamçe, ish-komandant i burgut, në kohën e ngjarjes, Halit Jella, ish-operativ i burgut në kohën e ngjarjes dhe në kohën e hetimit, si dhe Aqif Dardha, ish-kapter, që të tre anëtarë partie. Në raportin e Hetuesisë së Përgjithshme thuhet se hetimet janë në fazën përfundimtare. Janë kryer pyetjet direkte dhe do të fillojë ballafaqimi i të pandehurve me dëshmitarët. Nga hetimi arrihet në përfundimin se dy nga tre viktimat objekt hetimi janë vrarë nga persona me shërbim në Kampin e Bulqizës. Konkretisht, i dënuari Hysen Rakip Sadikaj, i dënuar me 17 vjet për përvetësim të pasurisë socialiste, në vitin 1953, është vrarë natën e datës 24.2.1957. Kjo vrasje ka qenë rezultat i një kombinacioni të përgatitur me kohë nga Hazbi Lamçe e Halit Jella. Hazbi Lamçe, duke e drejtuar vetë, si punën ushtarake administrative, ashtu dhe atë operative agjenturore, në bashkëpunim me punëtorin operativ Halit Jella, kanë provokuar nëpërmjet Musa Ismailit, një i burgosur në shërbim të organeve të punëve të brendshme, arratisjen nga kampi të të burgosurit Hysen Rakip Sadikaj, duke organizuar vrasjen e tij në telat me gjemba të rrethimit. Komandanti i burgut Hazbi Lamçe, i pyetur si i pandehur, pohon: “[...] Bashkëpunëtori i organeve tona, Musa Ismaili, na informoi se një grup të dënuarish duan të arratisen. Të dënuarin Musa Ismaili e udhëzua t’i udhëhiqte drejt telave, duke i caktuar vendin dhe e siguroam se ndaj tij nuk do të qitej me armë. Në pritë vendosëm oficerët Rexhep Gremi dhe Zaim Hysi. Ata u urdhëruan që të mos qëllonim ndaj të parit që do të kalonte telat, se ishte i yni, kurse mbi të tjerët të vepronin”.<sup>72</sup> Më tej deklarimi vazhdon: “Ne donim të vrisnim nga ky grup për të forcuar disiplinën, mora të gjitha masat ta fshihja këtë kombinacion, e analizuam rezultatin e kombinacionit dhe pamë se kishim dështuar, se nuk na erdhën të gjithë në pritë dhe Hysen Sadikaj nuk ishte më i rrezikshëm se të tjerët.”<sup>73</sup> Të nesërmen ka ardhur në kamp kryetari i Degës së Punëve të Brendshme të Peshkopisë, Muhedin Kërxxhalliu. Siç më tha Haliti, ai ishte shprehur se ky veprimi i juaj është i trashë, por ta lëmë me kaq”.

Deklarimet e të pandehurit Halit Jella janë si vijon:

“I burgosuri Musa Ismaili kishte denoncuar se katër të burgosur do të arratiseshin”. (Deklarimet e tij ishin të njëjta me deklaratimet e komandantit të burgut). Më tej ai vazhdon: “Unë vajta në

---

<sup>72</sup> Po aty.

<sup>73</sup> Po aty.

përrua dhe prita deri sa erdhi Musa Ismaili. Pas pak dëgjova qitje me automatik. E mora Musain dhe e çova në kamp e u ktheva në ngjarje. Pashë se ishte vratë Hysen Rakip Sadikaj. Të nesërmen erdhi në kamp kryetari i Degës së Punëve të Brendshme të Peshkopisë, Muhedin Kërzhalliu, që i tha Hazbiut: “U bë si u bë për situatën e krijuar në kamp, një pikë gjak duhej, por duhet të keni kujdes”.

Dëshmitari Rexhep Gremi deklaroi:

“Nja natë na thirri Hazbiu në zyrë, bashkë me Zaim Hysën dhe na thotë: Sonte do të arratisen të burgosur nga kampi. Kërkoj nga ju të zëvendësoni dy ushtarët që janë në vëndrojnë midis lokaleve të komandës dhe kazermës së policisë. Na urdhëroi që të burgosurin e parë ta lejonim të kalonte telat, të tjerët t’i vrisnim sa po të kalojnë telat. Pasi u ndezën motokompresorët, për të bërë zhurmë, shoh që po vinin në drejtim të telave dy të burgosur. I pari, me një dërrasë të madhe në dorë, e vuri dërrasën mbi tela dhe kaloi jashtë rrethimit. I dyti, porsa vuri duart në dërrasë u qëllua dhe u vra. Pastaj shkuam në zyrën e komandantit. Atje gjetëm Musa Ismailin (bashkëpunëtorin) të mbuluar me një kapotë, si dhe Halit Jellën (operativin). Hazbiu na kërkoi kartelën personale të Hysen Rakipit dhe unë ia çova, pra ai duhet ta dinte më përpara se i vrari ishte Hyseni. Ushtarët i thirri Hazbiu dhe u mori deklaratë që të mos flisnin dhe u dha leje”.

Në raportet e datës 20.03.1957, 25.05.1957 dhe 12.11.1957, Komandanti Hazbi Lamçe dhe operativi Halit Jella e kanë fshehur këtë situatë.<sup>74</sup>

Mbi vdekjen nga tortura të të burgosurit Seit Myrto.

Në bazë të të dhënave agjenturore të marra kohë më parë, Hazbi Lamçe dhe Halit Jella ishin vënë në dijeni se një grup të të burgosurish, i përbërë nga tre veta, mbrëmjen e datës 02.10.1957 do të arratisen nga një galeri e braktisur. Midis tyre që edhe i burgosuri Seit Myrto, ish-bashkëpunëtor i organeve të punëve të brendshme. Për përpunimin e grupit ishte vënë një i burgosur tjetër, bashkëpunëtori Tahir Muça. Mbrëmjen e datës 02.10.1957, kur tre të burgosurit tentuan të arratisen, panë se vendi ku do të dilnin jashtë ishte rrethuar nga roje të përforcuara, prandaj u kthyen në fjetore dhe arrestohen. Gjatë pyetjeve përdoret druri. Seit Myrto rrihet sa vjell gjak, humbet ndjenjat dhe më 05.10.1957 vdes. Lidhur me këtë ngjarje merren të gjitha masat dhe fshihet e vërteta. Me iniciativën e tyre Hazbi Lamçe dhe Halit Jella e nxjerrin kufomën nga varri dhe plotësojnë një raport fiktiv sikur vdekja ka ndodhur nga sëmundje të zemrës.

---

<sup>74</sup> Në historikun e kampit të Bulqizës thuhet se në vitin 1957 tentuan të arratisen tre të dënuar (Seit Myrto, Ibrahim Kujnxiu dhe Elmas Vesho) nëpërmjet një tuneli nëntokësor, nga galeria që të nxirrte 10 metra jashtë rrethimit, por plani i tyre dështoi sepse u kapën (në fakt njëri u vra në tela, tjetri u mbyt me tortura).

I pyetur për këtë ngjarje, Hazbi Lamçe deklaroi:

“Një natë lajmërohem me telefon se tre të burgosur kishin tentuar të arratisen. Urdhërova të izolohehen. Kur shkova në mëngjes kërkova t’i sillnin në zyrë. Më sollën vetëm dy, për të tretin, Seit Myrton, më thanë se ishte shtruar në infirmieri sepse nënoficeri Aqif Dardha e kishte rrahur rëndë dhe më vonë vdiq. E thirra Aqifin dhe ai pranoi dhe shtoi se përveç tij e kishin rrahur edhe Skënder Guri (komisari). Raportoi lart me telefon dhe na urdhëruan për të bërë autopsinë. Pas disa ditësh e nxuarën nga varri. Nuk pyeta në çfarë konkluzionesh dualën ekspertët. Formova bindjen se ky i burgosur duhet të kishte vdekur nga frika dhe nga rrahja e rëndë”.

Bashkëpunëtori Tahir Muça deklaroi:

“Duke qenë i ngarkuar nga Halit Jella (operativi) për të kontrolluar veprimet e grupit të përbërë nga Elmas Vesho, Ibrahim Kujnxiu dhe Seit Myrto, u kishte shfaqur dëshirën atyre (i kishte nxitur - shënimi im) për t’u arratisur dhe për këtë do të vinte në dijeni Halitin (operativin). Elmazi, - deklaroi T. Muça, - shumë kohë më parë më ka treguar planin e arratisjes. Për këtë vura në dijeni Halitin. 24 orë më para se do të ndodhte arratisja unë vajta dhe informova Hazbiun, por nuk më pranoi. E kuptova se e kishte marrë vesh çështjen nga gjetkë (dikush tjetër). Në darkë Elmazi, Seiti dhe Ibrahim u kapën. Të nesërmen Haliti më futi në birucë me detyrë të përgjoj bisedat e Elmazit me Ibrahimin. Për Seitin, nuk më tha gjë”.

Nënoficeri i policisë Abdulla Xhafa, anëtar partie deklaroi:

“Të burgosurit Seit Myrto dhe të tjerët që deshën të arratisen, në mëngjes në orën 07<sup>00</sup> m’i dorëzuan mua. U porosita të mos afrohet njeri tek birucat, përveç Halit Jellës. Mbas dy orësh u urdhërova që këta të burgosur t’i çoj tek Haliti. Shkova në birucë, por porta nuk hapej sepse e kishte zënë me trup i burgosuri. I fola me zë dhe nuk u përgjigj. Pastaj e shtyva portën dhe u hap. Pashë të burgosurin përmbys, të lidhur me fytyrë dhe duar të nxira, i dilte shkurmë nga goja, mernte frymë rrallë duke gërritur, ishte krejt i lagur”. Në këtë mënyrë shpjegon edhe denoncuesi i kësaj ngjarje Sulejman Haxhiu. Edhe dy të burgosurit e tjerë që tentuan të arratisen kanë deklaruar se janë rrahur nga H. Lamçe dhe H. Jella. Personat që kanë vënë dorë mbi të burgosurin S. Myrto janë Aqif Dardha dhe Skënder Guri (anëtar partie), ish-komisar i kampit dhe në momentin e hetimit oficer në Tiranë.

I pandehuri Aqif Dardha deklaroi:

“Meqë Seiti nuk i tregonte shokët, i shtrëngoja hekurat dhe e kam rrahur me shkop gjer sa erdhi Komisari Skënder Guri. Seiti bërtiste nga torturat. Mandaj e goditi komisar me hekur në kokë dhe pyetja e Seit Myrtos nga komisar vazhdoi deri sa zbardhi dita. Të nesërmen Hazbiu urdhëroi të më procedonte se kisha lënë të vdekur Seitin, por kur i thashë se e kam rrahur me komisar, ”

ai hoqi dorë nga procedimi. Seit Myrto u varros pa kryer formalitetet ligjore, këqyrjen e kufomës, akt-ekspertimin etj.”

Mbi vdekjen e të burgosurit Musa Ismaili.

I burgosuri Musa Ismaili, dënuar në vitin 1954 me 6 vite heqje lirie për vjedhje, është gjetur i plagosur për vdekje në fundin e një oxhaku galerie, natën e datës 2.08.1957, ku mbas tre orëve vdiq. Siç është përmendur, Musa Ismaili ka qenë në shërbim të organeve të punëve të brendshme, me ndikimin e të cilit u organizua vrasja e Hysen Rakip Sadikaj. Hetimet kanë treguar se përveç Hazbi Lamçes, Halit Jellës, Rexhep Gremit dhe Zaim Hysit, i vetmi që kishte dijeni mbi kombinacionin e organizuar ishte i burgosuri Musa Ismaili. Është provuar se Musa Ismaili ka kërkuar të lirohet para kohe për shërbimet që i kishte bërë komandës. Më vonë ka kërkuar të largohej nga Kampi i Bulqizës dhe të takohej me kuadro të Ministrisë. I burgosuri M. Ismaili kishte filluar të pëshpëriste me të burgosur të tjerë për ngjarjen. Më vonë Musai demaskohet në kamp nga Hazbi Lamçe e Halit Jella si intrigant, gënjeshtar, provokator, si njeri që në njërën anë përgatiste të burgosurit për arratisje, për të punuar gjoja kundër pushtetit popullor, ndërsa në anën tjetër i raportonte komandës.

Hazbi Lamçe deklaroi:

“Mbas kombinacioneve ne konstatuam se Musai kishte dezinformuar, sepse nuk i pruri të gjithë në pritë”.

Në raportin e datës 20.03.1957 vepra e Musait çmohet pozitivisht, kurse në raportin e datës 25.06.1957, dërguar Degës së Punëve të Brendshme Peshkopi, Musai konsiderohet provokator. Pas demaskimit, Musai dërgohet një muaj në birucë (izolim). Pas daljes nga izolimi dërgohet për të punuar në galeri. Gjashtë orë pasi filloi punën në galeri u gjet në fundin e një oxhaku i plagosur rëndë, ku pas tre orëve vdiq.

Të dhënat flasin se Musa Ismaili ka mundësi të jetë shtyrë në furnelë nga i burgosuri Ndue Deda, në bashkëpunim me brigadierin e burgosur Gjon Tarazhi, ish-bashkëpunëtor i organeve të punëve të brendshme, të nxitur nga Hazbi Lamçe dhe Halit Jella. Pas vrasjes së Musa Ismailit, Gjon Tarazhi lirohet nga burgu dhe mbahet në punë në minierë si brigadier i lirë. Ky konkluzion i hetuesisë nuk është i provuar, por ka dyshime të arsyeshme për t’u besuar.

Tiranë më 10.03.1969<sup>75</sup>

Nga Hetuesia/firma

Këto dëshmi për vrasje dhe tortura në burgjet komuniste vijnë nga burime zyrtare. Por kanë edhe një vlerë përgjithësuese për qindra raste të tjera, të cilat janë mbuluar nga shteti. Në këtë mënyrë janë eliminuar shumë të burgosur, veçanërisht politikë. Një prej tyre ka qenë Ali Maliq Agolli, i vrarë nga një bashkëvuajtës. Ngjarja është hetuar nga organet hetimore dhe vrasësi është dënuar nga gjykata. Por në lidhje me këtë ngjarje shumë ish-të burgosur politikë, bashkëkohës, dëshmojnë se kemi të bëjmë me një nxitje të sigurimit të shtetit. Në të vërtetë ne nuk mund ta provojmë këtë, por duke parë skena të tilla si kjo e Bulqizës, dyshojmë të kemi të njëjtin skenar.

Shumë ngjarje arratisjesh të renditura më lart, ka dyshime se mund të ketë që janë montuar nga komandat, për qëllime eliminimesh fizike apo ridënimi, në funksion të kontrollit mbi të dënuarët. Referuar raportit të Degës së Kampeve dhe Burgjeve, në vitin 1957 tre të dënuar (Seit Myrto, Ibrahim Kujnxiu, Elmaz Vesho) tentuan të arratisen nëpërmjet një tuneli nëntokësor, nga galeria që të nxirrte 10 metra jashtë rrethimit, por plani i tyre dështoi sepse u kapën. Kjo mospërputhje e madhe e informacioneve vjen se gjatë sistemit komunist ka munguar inspektimi i pavarur. Monitorimi i ekzekutimit të vendimeve penale, me dënim me burgim, por edhe arresti me burg ishte në kompetencë të prokurorive, të cilat bënin inspektime periodike, por këto të fundit ishin të përqendruara më shumë tek paraburgimet. Pra, ka dyshime të arsyeshme se mjaft ngjarje nuk janë raportuar siç në të vërtetë kanë ndodhur. Arratisjet ose tentativat për arratisje janë përdorur si mënyrë për të justifikuar terrorin e dhunën, në emër të disiplinës dhe forcimit të kontrollit, siç është konstatuar edhe nga hetimet e Hetuesisë së Përgjithshme. Një dyshim tjetër është se kur subjektet e arratisjes kanë qenë të dënuar politikë, janë bërë përpjekje të plota nga ana e komandave që e vërteta të mos zbulohet, duke patur natyrisht një qasje tjetër dhe një qëndrim të ndryshëm edhe nga organet e larta të pushtetit apo të drejtësisë.

### **Përfundime:**

- a) Kushtet e padurueshme të trajtimit në burgje, kampe pune dhe kampe internimi, shfrytëzimi me punë të detyrueshme në frontet më të vështira, në gjithë vendin, dhuna e vazhduar dhe një perspektivë e errët dhe e pashpresë, edhe pas daljes nga burgjet, ka qenë faktori nxitës kryesor që i ka shtyrë ish-të burgosurit e regjimit komunist drejt vendimeve për t'u arratisur, duke qenë të vetëdijshëm se mund të humbnin edhe jetën.

---

<sup>75</sup> Referuar në Regjistrin Themeltar Elektronik të gjendjes gjyqësore rezulton se

Hazbi Lamçe, ish-komandanti i burgut, është dënuar me vendimin Nr.7, datë 27.09.1969 për vrasje me 4 vjet burgim, e konvertuar në tre vite me kusht.

Halit Jella ish operativi i burgut është dënuar me vendim Nr.7, datë 27.09.1969 për vrasje me 2 vjet burgim, e konvertuar në dy vite me kusht.

- b) Të burgosurit që u arratisën nga burgjet e regjimit komunist ishin individë me profil psikologjik jashtëzakonisht të fortë, të udhëhequr nga një ndërthurje e guximit, bindjeve të forta dhe dëshirës për liri. Arratisja e tyre nuk ishte vetëm një akt fizik, por edhe një dëshmi psikologjike e rezistencës ndaj regjimit. Shumë prej të arratisurve ishin të burgosur politikë, me bindje të qarta antikomuniste dhe me një përjetim të thellë të padrejtësive të regjimit. Ata tregonin guxim të jashtëzakonshëm dhe një vullnet të pathyeshëm për të mos u nënshtruar dhe për të sfiduar kufirin ndërmjet jetës dhe vdekjes. Teknikat e realizimit të arratisjeve flasin për inteligjencë të shkallës së lartë, parapërgatitje shumë të sofistikuar dhe qetësi në sjelljet dhe veprimet e tyre, edhe në situatat më të rrezikshme për jetën.
- c) Në këtë studim nuk ishte e mundur që të kemi të dhëna të plota për përmasat e arratisjeve nga burgjet; sa arratisje kanë ndodhur në total, nga viti 1945, deri në vitin 1991. Sa janë vrarë gjatë arratisjes dhe sa janë ridënuar. Gjithashtu, na mungon informacioni për ngjarje konkrete, sepse njoftimet për arratisje janë dhënë telegrafike, të shkurtra dhe zakonisht pa emra. Përveç të tjerave, në shumë raste informacionet zyrtare janë përpjekur të shmangin përgjegjësitë e komandave në ngjarje.
- d) Nga analiza e të gjitha rasteve që u paraqitën në këtë trajtesë, rezulton se janë arratisur afërsisht 226 të burgosur, janë vrarë 28 dhe nuk janë kapur 77. Të tjerët janë kapur dhe dënuar me dënime të gjata dhe me vdekje. Besohet se numri i të burgosurve të arratisur është më i madh, por mungesa e dokumentacionit na vendos në pamundësi për të dhënë përmasat reale të arratisjeve nga burgjet e kampet. Kjo mbetet detyrë e studiuesve dhe institucioneve
- e) Dënimet e dhëna nga gjykatat nuk janë dhënë për largim nga vendi i vuajtjes së dënimit, por për arratisje, pra për tradhti ndaj Atdheut. Kështu dispozita e largimit nga vendi i vuajtjes së dënimit është zbatuar në raste të rralla, duke e kualifikuar veprën si tradhti ndaj atdheut. Gjatë arratisjeve, një numër i madh i ish të burgosurve janë ekzekutuar. Në këndvështrim edhe të akteve të kohës, asgjësimi është vlerësuar si mjet i fundit, por ndryshe është vepruar në praktikë. Ekzekutimet pa gjyq janë akuza akoma më të rënda për regjimin, ndërkohë kur shkelje të tilla ishin parashikuar me një dënim minimal.
- f) Siç paraqitëm më lart, ka raste të dokumentuara se arratisjet kanë qenë një lojë e komandave të burgjeve, duke nxitur të burgosur të veçantë, me qëllim për të justifikuar dhunën, terrorin dhe eliminimet fizike. Mungesa e hetimit dhe inspektimeve të brendshme, veçanërisht kur në ngjarje kanë qenë të përfshirë të burgosur politikë, ka nxitur më shumë komandat e burgjeve dhe të kampeve për veprime arbitrare.

Hysni Dhomi Porro ~~3/~~  
 I burgosur gjatë kohës  
 për një vit amerikan.  
 Në këtë kohë ndodhje veprimi  
 jo konform ligjeve të shpallura  
 dhe të rregullave të ligjeve.  
 asgjë më shumë të bëhet  
 sipas detyrës gjatë kohës  
 dhe në kushte të tilla me ligje  
 Hysni  
 14-VI-72

Kjo letër e firmosur nga Hysni Kapo është një dëshmi e qëndrimit ndaj kërkesave të ish-të dënuarve politikë, ndaj të cilëve ishte etiketimi zyrtar “armiq të popullit”, të cilin e gjejmë në të gjitha raportet, statistikat dhe vendimet e gjykatave.<sup>76</sup>

#### Rekomandime:

- Me qëllim administrimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e të gjithë informacioneve lidhur me arratisjet nga burgjet dhe kampet rekomandoj sistemimin e të gjitha dokumenteve arkivore dhe ngritjen e arkivës digjitale në një fond më vete.
- Studimin e plotë të të gjithë dokumentacionit lidhur me arratisjet dhe hartimin e një regjistri elektronik ku të administrohen të gjitha rastet dhe personat e arratisur.
- Do të ishte me vlerë jo vetëm në aspektin e kujtesës historike, por edhe në këndvështrimin e përvojës në kuadër të rritjes së sigurisë në institucionet e vuajtjes së dënimit, kryerja e një studimi lidhur me arratisjet në tre periudha, para lufte, gjatë regjimit komunist dhe pas viteve 90.

<sup>76</sup> Ndoshta bëhet fjalë për një ankesë dërguar Hysni Kapos nga Gjenerali Gjini Marku, i cili asokohe vuante dënimin e tij të parë me burgim 10-vjeçar.



## Bibliografia

### - Literatura

1. Dervishi, Kastriot. *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*. Tiranë: Shtypshkronja Maluka, 2015.
2. Elezi, Ismet, and Vasilika Hysi. *Politika Kriminale*. Tiranë: PEGI, 2006.
3. Fischer, Bernd. *Shqipëria 1943-1945. Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*. Tiranë: AIIS, 2012.
4. Sufaj, Femi. *Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shek. XX*. Tiranë: Albin, 2000.
5. Sufaj, Femi. *Sistemi i ndëshkimeve penale gjatë regjimit komunist: Disertacion për gradën "Doktor"*. Tiranë: Shtëpia Botuese Dita 2000, 2014.
6. Shkëmbi, Hasan. *Historia e Policisë*. Tiranë, 1996.

### - Materiale arkivorë

- Arkivi Qendror i Shtetit

1. F. 255, V.1920, D 1399, Arkivi Qendror i Shtetit.
2. F. 14, V.1957, D 15, fl.1-6, Arkivi Qendror i Shtetit, K. Q. i PPSH.
3. F. 492, V.1958, D 28, Arkivi Qendror i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme.
4. F. 492, V.1960, D 37, Arkivi Qendror i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme.
5. F. 492, V.1964, D 58, Arkivi Qendror i Shtetit, Përgjithësim mbi arrestimet 1961-1964.
6. F. 492, V.1967, D 60, Arkivi Qendror i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme
7. F. 492, V.1969, D 66, Arkivi Qendror i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme.
8. F. 494, V.1963, D 418, Arkivi Qendror i Shtetit.
9. F. 515, V.1944, D 2, fl.2, Arkivi Qendror i Shtetit, Ministria e Drejtësisë.
10. F. 515, V.1944, D 4, fl.20, Arkivi Qendror i Shtetit, Ministria e Drejtësisë.
11. F. 516, V.1945, D 9, fl.2, Arkivi Qendror i Shtetit.
12. F. 516, V.1945, D 15, fl.1, Arkivi Qendror i Shtetit.
13. F. 516, V.1945, D 17, fl.2, Arkivi Qendror i Shtetit.
14. F. 516, V.1946, D 20, fl.9, Arkivi Qendror i Shtetit.
15. F. 516, V.1946, D 20, fl.11, Arkivi Qendror i Shtetit.
16. F. 516, V.1947, D 20, fl.9, Arkivi Qendror i Shtetit.
17. F. 890, V.1956, D 64, fl.28 Arkivi Qendror i Shtetit, Këshilli i Ministrave.
18. F. 890, V.1970, D 255, Arkivi Qendror i Shtetit, Kuvendi Popullor.

- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme

19. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 10, V.1950, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
20. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 30, V.1953, Arkivi i Ministrisë së Brendshme.
21. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 45, V.1965, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
22. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 47, V.1956, Arkivi i Ministrisë së Brendshme.
23. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 50, V.1950, Arkivi i Ministrisë së Brendshme.
24. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 71, V.1959, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
25. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D.80, V.1960, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
26. F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, D 80, V.1962, Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

27. F. Kampet dhe Burgjet, D 113, V.1964, *Arkivi Ministrisë së Brendshme*.
28. F. Kampet dhe Burgjet, D 133, V.1967, *Arkivi Ministrisë së Brendshme*.
29. F. Kampet dhe Burgjet, D 142, V.1971, *Arkivi Ministrisë së Brendshme*.

**- Dokumente të ndryshme**

1. Fletore zyrtare, nr.20, datë korrik 1951.
2. Gazeta Zyrtare, nr.12, datë 22 maj 1945.
3. Historiku i Repartit 313, dorëshkrim.
4. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë (1946).

**- Webfaqe**

1. “1953/Arratisja e katër të burgosurve nga Kampi nr.1 Rinas,” Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, <https://kujto.al/1953-arratisja-e-kater-te-burgosurve-nga-kampi-nr-1-rinas/>.
2. Dervishi, Kastriot. “Historia -Tentoi të arratisëj, por vuajti 32 vite burg në diktaturë.” Lapsi.al, <https://lapsi.al/2018/11/05/historia-tentoi-te-arratisj-por-vuajti-32-vite-burg-ne-diktature/>.
1. Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit. “1953/Arratisja e katër të burgosurve nga Kampi nr.1 Rinas,” <https://kujto.al/1953-arratisja-e-kater-te-burgosurve-nga-kampi-nr-1-rinas/>.